

Резюме

К ВОПРОСУ ОБ ОСВЕЩЕНИИ ЭПОХИ СКАНДЕРБЕГА

Али Хадри

До настоящего времени историография не смогла осветить всесторонне и объективно историческую личность Джердже (Георга) Кастриот-Скандербега. Не написаны отдельные работы по некоторым основным вопросам из истории албанского движения против турецких захватчиков в XV веке. Почти ни одна из многочисленных работ о Джердже Кастриот-Скандербеге не может рассматриваться как целостная объективная научная работа. Большинство авторов воспользовались литературой и мемуарным материалом или, частично, существующим обширным архивным материалом. Все они, главным образом, толковали с идеалистической точки зрения место и роль этой личности. Однако для специальных работ по этому вопросу могут быть использованы многие данные из таких опубликованных произведений. Вполне понятно, что проверка правдивости объявленных фактов при помощи опубликованного исторического и неопубликованного архивного материала является необходимой, потому что многие опубликованные данные бывают неточными. Также является необходимой проверка достоверности архивного материала, потому что существует разница между различными источниками, в особенности между турецкими и нетурецкими. Все это заставило нас в настоящей работе осветить, по мере возможности, лишь некоторые вопросы из эпохи Скандербега: 1) периодизацию албанского движения в эпоху Скандербега, 2) внутренние и внешние обстоятельства, под которыми боролись албанцы, 3) отношения между Скандербегом, Джурдже Бранковичем и Венецианской республикой и 4) роль Джердже Кастриот-Скандербега в борьбе с Турцией. Главным вопросом считаем роль и место Джердже Кастриот-Скандербега в албанском движении против турецких завоевателей (1443—1468). Мы попытались в духе исторического материализма дать научный ответ на этот фундаментальный вопрос и, в то же время, дать научную установку остальных вопросов, излагаемых в этой работе. Мы считаем, что этот очерк представляет скромный вклад в благодарную работу обработки одного будущего марксистского научного произведения об албанском движении под предводительством Джердже Кастриот-Скандербега.

Одним из основных вопросов албанского движения 1443—1468 годов была проблема периодизации эпохи Скандербега. Эта эпоха албанского исторического прошлого подвергалась различным периодизациям. Мы

рассматриваем эпоху Скандербега только лишь как одну часть, правда самую прославленную, албанской средневековой истории. С другой стороны, эта эпоха является частью албанского движения в борьбе с турецкими завоевателями, которое ведет начало с того времени, когда турецкие завоеватели, после битвы на Марице, проникают на албанскую территорию и продолжается вплоть до окончательного освобождения Албании в 1912 году. По нашему мнению албанское движение против Турции в эпоху Джердже Кастриот-Скандербега можно разделить на три периода: первый период охватывает 1443—1450 годы, второй — 1451—1461, а третий 1462—1468 годы. Введением в эпоху Скандербега должно служить тяжелое положение населения значительной части Албании, которое подпало под Турцию, вплоть до 1443, когда Джердже Кастриот-Скандербег становится во главе движения, а также сложившиеся в то время отношения на Балканах и отношения небалканских стран к Турции. Такая периодизация эпохи Скандербега не проведена по педагогическим соображениям — чтобы исторический материал легче запоминался в учебном процессе или чтобы читатели имели лучший обзор, — а вытекает из исторических событий албанского движения в эту эпоху. Узловыми моментами этой периодизации взяты самые значительные события, давшие направление всё более успешно развивавшемуся сопротивлению. Каждый из этих периодов представляет отдельную часть единого целого — эпохи Скандербега.

Чтобы дать правильное освещение эпохи Скандербега, нужно изобразить внутренние и внешние обстоятельства, из которых нарождалось и развивалось албанское движение против турецких завоевателей. До установления турецкой власти в Албании господствовала феодальная система, наставшая в результате внутреннего развития (главным образом в равнинах), а и внешних влияний, приходящих из соседних феодальных государств и от анжуйцев. Установлением военно-помещичьей турецкой системы на территории Албании создаётся своеобразное тяжёлое положение для всех албанских общественных сословий того периода. От этой системы в особенности страдало крестьянское население, которое стало турецкой рабьей. Тяжёлая жизнь под турецким военно-помещичьим строем и желание получить свободу вызвали сопротивление албанской раи. Еще до эпохи Скандербега албанское сопротивление выражалось в двух основных видах: пассивном и активном. Сопротивление до 1443 года не имело положительных результатов потому что носило местный характер и не приводило к сотрудничеству другие балканские страны. Наряду с внутренними, и внешние обстоятельства имеют значение для зарождения и развития албанского движения в борьбе с Турцией в эпоху Скандербега. До этой эпохи, а и в течение ее, на Балканах велась борьба за защиту независимости балканских народов, потому что Турция их постепенно покоряла. С другой стороны, турки имели завоевательские aspirations и по отношению к Венгрии и Австрии. Поэтому Иован Хуняди ведет борьбу с Турцией считая, что лучше врага сломить на Балканах, чем на своей территории. И антитурецкие сепаратистские движения на Востоке способствовали сопротивлению под Скандербегом. Но, несомненно, внутренние факторы имели первостепенное значение по отношению к внешним условиям, имеющим второстепенное значение в деле албанского движения 1443—1468 годов.

Не только внутренние и внешние обстоятельства, но и отношения между Скандербегом, Венецианской республикой и Джурдже Бранковичем,

а также и отношения с Неаполитанским королевством, римским папой, Зетой, Дубровником и Боснией представляют важные факторы в правильном освещении эпохи Скандербега, так как они, несомненно, оказали влияние на албанское движение XV века, а и были под влиянием его. Что касается отношений между Скандербегом и упомянутыми странами и римским папой до настоящего времени в историографии были различные положения. Между ними есть и необъективные, потому что некоторые толкования даны с точки зрения субъективных политических соображений. Больше всего было ошибочных положений в оценке отношений между Скандербегом и Джурдже Бранковичем. Здесь имеем даже подделку исторической правды. А именно, в историографии существует мнение, будто между ними была вражда, потому что, якобы, сербский деспот не дал согласие Скандербегу с его войсками перейти в Сербию, для того чтобы помочь христианским войскам в битвах при Варне в 1444 и на Косово в 1448 году. Такое мнение защищают многие иностранные, югославские и албанские историки. Мы можем с полным правом утверждать, что исторические факты опровергают мнения многих историков о том, что Джурдаж Бранкович и Скандербег были во враждебных взаимных отношениях. Факты говорят не только о том, что их сотрудничество было естественным последствием опасности, грозящей от Турции, но и о том, что по объему оно было гораздо шире, чем это утверждалось в существующей до сих пор историографии. Особенное значение имеют отношения между Скандербегом и Венецией. И на этот вопрос не дан научный ответ. Эти отношения не были рассматриваемы с более широкого аспекта — обозначало ли существование венецианской власти отсрочку падения Албании под власть Турции. В турецкой историографии встречаем положение, по которому Скандербег в тесном сотрудничестве с Венецией убивал турок при каждой встрече с ними и будто бы, связавшись с Венецией и папой, боролся в действительности за интересы, за католицизм. Существует и противоположное положение, по которому Скандербег и Венеция были, можно сказать, в непрекращающихся враждебных отношениях. Такого положения придерживаются особенно в современной албанской историографии. Мы считаем, что отношения между Скандербегом и Венецией имели две неразрывные компоненты: одна выражала противоборств, а вторая примирительство и сотрудничество. В случае, когда брала верх первая компонента, турецкие завоеватели легче покоряли албанские территории, а когда доходила до выражения вторая, то это усиливало совместное сопротивление против Турции. Всё это происходило в зависимости от моментальных интересов Венеции или самого Скандербега и от существующих обстоятельств; но каждая сторона представляла возможную спасность для второй, ибо албанское движение в эпоху Скандербега несмотря на то, что оно было преимущественно направлено против Турции, обозначало в конечном пункте отрицание венецианской власти в Албании, и наоборот — существование венецианской власти в Албании, хотя она и должна была бороться с Турцией, представляло также в крайней линии отрицание миссии Скандербега в деле объединения и формирования албанского государства.

В период с 1443-1468 годы албанцы, под предводительством Скандербега, оказали героическое сопротивление туркам, которым не удалось в течение четверти столетия покорить Албанию, несмотря на превосходство в войсках и вооружении. Победы, которые одержали албанцы в этот

период сделали из Джердже Кастриот-Скандербега не только самой замечательной исторической фигурой в средневековой албанской истории, но и одним из самых выдающихся военных талантов на Западе. Историческое значение сопротивления албанцев в борьбе с турками в эпоху Скандербега становится еще более ясным, если иметь в виду, что сопротивление оказывается именно в тот период, когда турки старались окончательно покорить Балканский полуостров и уничтожить Византию. Поэтому, это сопротивление албанцев имеет такое историческое значение, которое превосходит рамки албанской национальной истории и вместе с сопротивлением сербов обозначает вклад не только в защиту Балканов, но и в замедление проникновения турецких войск в Европу. Скандербег имеет большие заслуги не только как полководец, но и как объединитель албанцев в борьбе с турками, и это наблюдается с самого начала албанского движения. Особенное историческое значение имеет Скандербег и как дальновидный политик. Он умел использовать настоящий момент для начала объединенного сопротивления против турецких завоевателей (после битвы возле города Ниша в 1443 году). Затем, он использовал не только внутренние силы, но и внешние обстоятельства, как только они были выгодными и обеспечивали помощь союзников (союз с Альфонсом V, Иованом Хуняди, одно время и с Венецианской республикой, а также и вполне естественный союз с Джурдже Бранковичем и Чарноевичами). Всё это показывает, почему именно Скандербег, а не какой-нибудь другой албанский предводитель, стоял во главе албанского движения в период с 1443 по 1468 год. Кроме Скандербега, значительную роль в албанском движении в борьбе с турецкими завоевателями имели также и остальные главари: Джердж Арианити, Дукаджини, Мойси Големи, Андру Топия, Тодор Музака, Лек Захарије и мелкие феодалы. Основная причина их активного участия в этом движении было желание освободиться турецкого ига, а в частности сохранить свои классовые, экономическо-общественные и политические позиции на территории Албании. По нашему мнению решающую роль в албанском движении против турецких завоевателей в эпоху Скандербега имели широкие народные массы, которые создавали основу этого движения. Крестьяне, до решающих боев, наносили большие потери турецким войскам в различных ущельях и подходах. Войска Скандербега, а также и одна часть командного состава были составлены главным образом из крестьян. Без их массового участия и подумать нельзя было о каком-либо выступлении против турок. Основной причиной такого широкого участия крестьянства в движении против турок было стремление освободиться турецкого ига и в то же время сбросить с себя бремя военно-помещичьей системы. В заключение можно сказать, что четвертьвековое албанское движение против турецких завоевателей, в котором первостепенную роль сыграли народные массы, неразрывно связан с личностью Скандербега как предводителя, и поэтому с правом можно назвать этот период эпохой Скандербега.

The first of these is the fact that the United States is a young nation. It is only about 150 years old, and its history is therefore a history of rapid growth and development. The second fact is that the United States is a large nation. It covers a vast area of land, and its population is one of the largest in the world. The third fact is that the United States is a diverse nation. It is made up of many different peoples, races, and religions, and this diversity has been one of its strengths. The fourth fact is that the United States is a free nation. It is a country where the people have the right to speak their minds, to worship as they please, and to live as they see fit. These four facts are the foundation of the United States, and they have helped to make it one of the most powerful and successful nations in the world.

The fifth fact is that the United States is a nation of opportunity. It is a country where anyone can succeed if they work hard enough. The sixth fact is that the United States is a nation of progress. It is a country that is always moving forward, always seeking to improve itself. The seventh fact is that the United States is a nation of peace. It is a country that has never been at war with itself, and it has always sought to live in peace with the rest of the world. These seven facts are the pillars of the United States, and they have helped to make it one of the most beloved and respected nations in the world.

Shefqet Pllana

Puna në kangët popullore shqiptare

Me marrë për objekt studimi punën në raporte me kangët popullore shqiptare do të thotë me trajtue çashtjen më elementare të këtij arti popullor. Ky pohim mbështetet në vërtetësinë simbas së cilës si kangët popullore ashtu edhe format e tjera të të shprehurit artistik të njeriut, qoftë kolektiv a individual, janë rezultat të punës së vazhdueshme që ushtron njeriu. Puna si fenomen shoqnor kryesor pasqyrohet qartë në çfarëdo forme artistike, e sidomos në krijimtarinë popullore, e cila është pikënisje e të gjitha përfundimeve artistike të njeriut.¹

Në kohën e fundit folkloristika dhe etnomuzikologjia kanë rrahë me zgjidhë një varg çashtjesh të randësishme nga lania e folklorit shqiptar, para së cilave qëndrojnë një seri problemesh serioze për t'u ndriçue, në rend të parë zanafilla, zhvillimi dhe motiologjia e krijimtarisë artistike popullore shqiptare. Ky imperativ shkencor na nxit posaçërisht të thellohemi në të zbuluemit e ligjshmenive themelore të strukturës dinamike t'artit tonë popullor, në këte rast të kangëve popullore shqiptare. Në këte mënyrë do të jemi në gjendje me i pá dhe me i kuptue më lehtë raportet që kanë poezia dhe muzika popullore shqiptare me jetën e popullit si në kohë të lashta, në periudha shoqnore më të vonshme, ashtu edhe në këte bashkëkohore, në të cilën arti popullor po gjurmohet me të madhe.

Nga vetë landa e folklorit shqiptar kuptojmë rolin e randësisëm që luen puna në të sajuemit e një numri të kangëve popullore, madje, disa nga të cilat këndohen gjatë punës, si do të shohim, edhe sot e kësaj dite. Mirëpo, hetojmë mirëfilli, gjithashtu, se ritmet e kë-

1 Për hir të randësisë së madhe që paraqet puna në relacione me krijimtarinë artistike popullore, kjo çashtje që objekt studimesh të veçantë në Kongresin e VIII të Lidhjes së folkloristëve të Jugosllavisë, në shtator të vjetit 1961. Të njimbëdhetë koreferatet në lidhje me temën e veçantë të këtij tubimi shkencor *Rad u narodnom umetničkom stvaralaštvu*, prej të cilave, edhe ai i shkruarit të këtyne radhëve *Rad kao motiv u arbanaškoj narodnoj pesmi*, vërtetuen dhe ravizuen edhe njëherë vendin që ze dhe rolin që luen puna në krijimtarinë artistike të popullit, sidomos në motiologjinë e poezisë popullore.

tyne kangëve nuk përkojnë plotësisht me ritmin e lëvizjeve të njerëzvet punues, të cilët i këndojnë gjatë punës përkatëse, mbasi këto diferencohen në mes veti. Prandej nuk shkojmë kah pikëpamja që zanafillen e kangëve të tilla (qofshin edhe ndër popuj të tjerë) ta lidhim me procese mekanike-ritmike të punës, si ndeshim ndonjiherë në synimet arbitrare të ndonji teoriku, — por ravizojmë të paraqitunit elementar dhe motivologjik të punës në landën e tyne poetike-muzikore. Lidhun me këte, materiali që parashtrojmë dhe vrojtimet tona nuk përkojnë me hipotezën e Byherit² simbas së cilës muzika dhe poezia kanë lindë nga tingujt që kanë përcjellë saktësisht lëvizjet e barabarta në punë, që, madje, kanë shërbye në fillim që të ruhen sa më tepër këto lëvizje të barabarta.³ Përveç kësaj, Byheri çfaqte besimin se jo vetëm f o r m a por edhe p e r m b a j t j a e poezisë e ka zanafillën në lëvizjet ritmike energjike të trupit të njeriut, sidomos n'ato lëvizje që i quejmë punë.⁴ Merita kryesore e këtij ekonomisti gjerman qëndron në faktin se tue na dhanë material poetik të pasun i tërhoq i pari vemendjen shkencës mbi lidhjet e ngushta të muzikës dhe poezisë me procesin e prodhimit, porse në të spieguemit e këtyne raporteve ra në pozita të materializmit vulgar. Ai, në të vërtetë, e mbështeti hipotezën e vet në bindjen e gabueshme tue e ndërrue konceptin e ritmit me konceptin e metrit. Ky gabim themelor i teorisë së tij „teknike-fiziologjike” mbi zanafillën e muzikës dhe të poezisë zbulohet nga vetë fakti që pjesa më e madhe e materialit që parashtron, përbâhet nga kangët të cilat i përkasin shkallëve më të ulta të zhvillimit shoqnor.⁵ N'anën tjetër, rezultatet e deritashme të shkencës i japin përgjegje negative pyetjes se ritmi i ndërrmarrjeve fillestare të njeriut a ka caktue rreptësisht ritmin e kangëve të para. Ritmi i kangëve që paraqet Byheri si më të lashtat, të cilat, madje, i citon edhe Plehanovi kur ban fjalë mbi zanafillën e krijimtarisë artistike në baza materialistike,⁶ dallohet nga ritmi i prodhimit. Nga vetë shembujt e kangëve të Byherit, shkenca heton se është fjala për një punë t'atillë, e cila ka mujtë me u dukë aty kah fundi i shkallës së ultë t'egërsisë, e cila është karakteristike për klane dhe popuj në shkallë të ndryshme të barbarizmit (simbas terminologjisë së Morganit dhe Engelsit mbi periodizimin e zhvillimit të njerëzimit). Kurse kanga e ka zanafillën shumë më heret dhe të lidhun me punë krejtësisht të tjera: me vjeljen e rranjëve, fryteve të ndryshme, që u shërbejshin njerëzve si ushqim.⁷ Ndërkaq, pjesa më e madhe e kangëve që Byheri i merr si shembuj nga popujt e mbrapambetun — si heton dijetari Gruber — me

2 Karl Bücher, *Arbeit und Rhythmus*, Leipzig, 1896.

3 Krah. P. И. Грубер, *История музыкальной культуры I*, Москва, 1941, fq. 155; Josip Andreis, *Historija muzike I*, Zagreb, 1951, fq. 17.

4 Krah. K. Bücher, vep. e cit. fq. 80, simbas G. V. Plehanov, *Umetnost i književnost I*, Beograd, 1949, fq. 109.

5 Krah. P. И. Грубер, vep. e cit. fq. 155.

6 Krah. G. V. Plehanov, vep. e cit. fq. 79-80.

7 Krah. Војислав Ђурић, *Постанак и развој народне књижевности*, треће изд. Београд, 1956, fq. 91.

ritmet e tyne të komplikuar e tejkalojnë thjeshtësinë e lëvizjeve të procesit të prodhimit, që madje, gjithashtu nuk janë gjithmonë të barabarta.⁸ Mandej të shtojmë se edhe vërtetimet e shumicës së shkencëtarëve tregojnë që ritmi i kangëve rreth punëve nuk përkon gjithnjë me ritmin e lëvizjeve të njerëzve në procesin e prodhimit, — madje në disa raste një melodi e njëjtë përdoret gjatë operacioneve të punës me ritme të ndryshme.⁹ Kjo ligjshmëri hetohet edhe në materialin e folklorit shqiptar që po shtrojmë në vijim të kësaj trajtese.

Zgjidhja e problemit të zanafillës së muzikës dhe poezisë (si edhe e arteve të tjera) është punë e vështirë dhe e koklavitun, pse nga mungesa e të dhanave burimore rreth njeriut fillestar ekzistojnë shumë çashtje që nuk mund t'u jepen përgjegje drejtëpërdrejtë. Përveç Byherit, rreth hipotezës së të cilit u ndalëm më gjatë nga se tema jonë ka pikëpyetje me të, një plejadë teorikësh të tjerë: H. Spencer, Ch. Darwin, C. Stumpf, C. Sachs, M. Weber, R. Wallaschek. J. Combarieu etj. u rrekën me zgjidhje këte problem. Mirëpo, ata tue u nisë nga aspektet e njanshme, kanë vërejtë vetëm ngandonji element të zhvillimit muzikor e poetik, dhe tue i izolue nga faktorët e tjerë, gjenezën e muzikës dhe të poezisë nuk e shikuen dhe nuk e spieguen në tërësinë e tyre, në rend të parë si fenomen shoqnor.¹⁰ Në të kuptuemit sa më të drejtë të dukunisë s'arteve në përgjithësi, kanë randësi të madhe pohimet marksiste-leniniste, të cilat zanafillën e tyre e kundrojnë si rrjedhim të veprimtarive të ndryshme shoqnore dhe të lidhun ngusht me lindjen e gjuhës, të menduemit, me të gjitha kulturat e para, të cilat në fillim përfshijshin edhe kangën.¹¹ Kjo metodë shkencore i zbrit në mënyrë logjike raportet midis të gjitha këtyne fenomeneve dhe veprimtarive shoqnore. Puna ka qenë padyshim si thotë Engelsi „... kushti i parë themelor i krejt jetës njerëzore, madje në një masë kaq të madhe sa që në një mënyrë duhet patjetër të themi: *puna e krijoi njeriun*.”¹² Të folunit dhe gjuha e njeriut, elemente thelbore të kangës, erdhën si rezultat të bashkëpunimit të njerëzvet në procesin e punës gjatë pushtimit të natyrës. „Në fillim puna, fill mbas saj dhe së bashku me të të folunit — thotë Engelsi — këto janë dy shtytjet më esenciale në ndikimin e të cilavet truni i majmunit është shndërrue në tru njeriu...”¹³ Mirëpo dukunia e të folunit, gjuhës, është e pamundun pa paraqitjen e njikohësishme të vetëdijes, ndërgjegjies së njeriut, e cila gjithashtu mbështetet në procesin e punës. Marksistët theksojnë veçanërisht këte: „Gjuha është aq e vjetër sa edhe vetëdija, — gjuha, madje, është vetëdija praktike e vërtetë që ekziston për njerëzit e tjerë, dhe mandej

8 Krah. P. И. Грыбев, vep. e cit. fq. 155.

9 Krah. P. И. Грыбев, vep. e cit. fq. 155; В. Бурих, vep. e cit. fq. 91-92.

10 Krah. P. И. Грыбев, vep. e cit. fq. 154-159; J. Andreis, vep. e cit. fq. 17-18.

11 Ma gjatë në kapitullin: *Zanafilla e poezisë dhe fazat e para të zhvillimit të saj*, në librin *Русское народное поэтическое творчество*, под общей редакцией проф. П. Г. Богатырева, изд. второе, Москва, fq. 169-176.

12 F. Engels, *Dialektika prirode*, Beograd, 1951, fq. 172. Kurzivi ynë.

13 Po aty, fq. 176.

pasojisht edhe për mue, kurse gjuha lind si edhe vetëdija nga nevoja, nga domosdoshmenia për marrëveshje me njerëzit e tjerë."¹⁴ Gjuha simbas këtyne pohimeve, materializon dhe realizon të menduemit, prandej përputhen në mënyrë dialektike.¹⁵ Përkitazi me trajtesën tonë, kjo vërtetësi është jashtzakonisht e randësishme, pse ky të folun i njeriut, kjo gjuhë, bëhet landë e poezisë, në të cilën reflektohet të menduemit e njeriut dhe gjendja e tij ekonomike e kushtësueme nga fuqitë e mjeteve të prodhimit. Ky të folun, kjo gjuhë, në fillim ka nisë dhe është zhvillue vetëm nëpërmjet të kangës. Pra k a n g a e së bashku me të poezia, është forma më e lashtë e veprimtarisë së njeriut e shprehun me anën e fjalëvevet.¹⁶ Mandej, njeriu krijoi me punë gjatë mija shekujve kushtet e jetesës dhe tue i zhvillue mjetet e prodhimit shkon tue tëhollue gjithnjë e më tepër dorën, dhe kështu fiton aftësinë me krijue vepra të nalta artistike, pse, si thotë përsëri Engelsi „... dora nuk është vetëm organ i punës, ajo është edhe prodhim i saj. Vetëm me punë... dora e njeriut ka mbërri shkallën e naltë të përsosunisë me çka ka mujtë me krijue piktura të Rafaelit, trupore të Torvaldsenit dhe muzikën e Paganinit."¹⁷

Sa i përket krijimtarisë poetike popullore — si ven në pah profesor Bagatyróvi — ajo është e lidhun në mënyrë të pandashme me veprimtarinë punuese të popullit gjatë të gjitha etapave të zhvillimit të saj. Në punë sajohen shumë vepra të folklorit. Poezia rituale kalendarike (te ne e pagëzueme me termin *kangët e motmotit*) dhe ajo familjare, të cilat burojnë që nga komuniteti primitiv, gjithmonë kanë qenë të lidhuna me punën e bujkut dhe të blegtorit.¹⁸ Puna ka qenë — si pohon M. Gorki — prorre çelës i të gjitha sekreteve të jetës. Proceset e punës kanë krijue parimet themelore të kulturës, por nuk janë studjue në mënyrë të gjithanshme dhe thellë si meritojnë, pse studimet e tilla nuk shkojnë n'interes të shtypësve, të cilët energjinë e masave e shndërrojnë në të holla si ndonji landë të parë, prandej nuk kanë mujtë me i rritë vleftën kësaj lande të parë.¹⁹ Në punimin tonë synojmë ta pasqyrojmë punën sa më mirë me të gjitha vetitë që ajo ka në gjiun e kangëve popullore shqiptare. Prandej këte çashtje e shtrojmë në katër pikëpamje: 1. n'aspektin e rolit që luan puna në të sajuemit e disa kangëve, por tue pasë parasysh botëkuptimet materialistike; 2. në drejtim që të zbrisim rolin dhe randësinë e kangës si mjet utilitar të punuesve në punën përkatëse; 3. të ravizojmë punën në pikëpamje motivologjike, pse ate e hetojmë si një ndër motivet bërthamore të kangëve tona popullore, dhe 4. të vlerësojmë karakterin shoqnor të punës në periudha shoqnore të

14 Marks-Engels, *Rani radovi*, Beograd, 1953, fq. 297.

15 Krah. Ilija Kosanović, *Dijalektički materijalizam*, Sarajevo, 1956, fq. 192-193.

16 Krah. B. Ђурић, vep. e cit. fq. 12-13; Prej shkrimtarit të njajtë edhe *Порекло поезије и извори њеног развика*, Beograd, 1950, fq. 5-6.

17 F. Engels, *Dijalektika prirode*, vep. e cit. fq. 174.

18 Krah. *Русское народное поэтическое творчество*, vep. e cit. fq. 7.

19 Krah. Maksim Gorki, *O literaturi*, Beograd, 1949, fq. 120, 178.

ndryshme, veti kjo që pasqyrohet në landën e kangëve popullore shqiptare të vjetra dhe të reja të cilat janë sintezë e rrëfimit poetik, muzikor e filozofik të popullit tonë. Për hir të sqarimit më të plotë të këtyne çashtjeve që po i trajtojmë, e që paraqesin problematikë shumë të ndërlikuese, por me interes për folkloristikën dhe etnomuzikologjinë, jemi të detyruem me i përcjellë shkurtimisht mënyrët dhe rastet në të cilat paraqitet puna ndër gjini dhe farë të ndryshme të kangëve popullore shqiptare, tue fillue, madje, nga ato me karakter motivologjik më të lashtë.

1. Gjuetia si motiv në kangët tona popullore

Gjuetia ekziston si motiv në kangët popullore shqiptare, por ajo na reflektohet ndryshe në krahasim me ato të grupeve etnike primitive. Kjo vjen nga shkaku se popullsia shqiptare jeton në kushte shumë më të përparueme, ku gjuetia ka pushue kaherë së qenuri i vetmi burim ekonomik. Megjithëkëtë, gjuetinë e hetojmë si motiv edhe në kangët tona motivologjikisht mjaft të lashta. Nji shembull të tillë paraqet *Kanga e Halilit dhe Rrahmanit*.²⁰ Protagonistët e saj hypun në kuaj dhe të shoqnuem nga zagarë dhe sokola shkojnë në pyll për gjah. Me këte rast hetojmë se marrëdhëniet familjare midis këtyne dy vllazënve ndikojnë në punën e tyre gjatë gjuetisë. Kështu, kali dhe zagari i Rrahmanit nuk ndjekin dhelpnën për ta zanë nga se i zoti i tyre, nën ndikimin e shpifjes së grues, ka therrë të vllanë, Halilin. Por, kur Rrahmani pendohet për të keqen që ka bâ dhe tue qe me dënësë këthehet te Halili i mbyttun, atbotë kali i tij i cili deri më ate çast e ruente besnikisht kufomën e të zot, e ringjall tue i hukatë në plagë. Mbas kësaj dy vllazënve të përqa-fuem u shkon për dore me zanë po ate dhelpën me anën e kuajvet dhe të zagarëvet që tash kryejnë me kënaqësi plotësisht detyrën e tyre. Pra, me të mënjanuemit e mosmarrëveshjes dhe të rikëthimit të harmonisë e të dashunisë vllaznore, gjuetia e tyre merr rrugën e mbarë, dukuni kjo që ravizon poetikisht randësinë e mirëkuptimit midis njerëzve gjatë procesit të punës, që është kusht i domosdoshëm për lumtuninë jetësore.

Megjithëse folkloristika jonë nuk disponon shumë kangë të përshkrueme me gjuetinë si motiv, çka besojmë se mund t'i qesin në pah, sadopak, kërkimet folklorike në teren, prapseprap figura e gjuetarit gërshetohet në nji numër kangësh tona popullore, të cilat shtjellojnë motivin e dashunisë. Nji kangë të tillë, me tri zane, e mblodhëm në katundin Gërncar të Prespës:

*Eo, ej do mar çiftin, o moj, do dal për gjah,
Aman, shokë, more, aman, more, aman**

*E çiftinë, o moj, me gjith' zagar,
E se ç'u ngjita më një malë,
E pashë, o moj, tri të bukura,
— E cila të pëlqenë me fjalë?*

²⁰ Kangën e shënoi Harhi Krasniqi në kat. Dubravë të Kaçanikut. Le të shihet në vazhdim të kësaj reviste ku ajo botohet në tanësi.

* Ky varg përsëritet si refren mbas çdo vargu të kësaj kange.

— E ajo me fustanë të bardhë.
 E do ta mar, o moj, oqiç manar,
 E do ta gjezdis stan' e mi stanë,
 Do ta ushqej me mish, me bukëvalë!²¹

Në disa kangë me karakter gastor, të cilat këndohen sidomos në darsma, përqeshet ngathtësia e gjuetarit dhe vëhet në lojë me vargje shpotitëse. Karakterin arkaik të kangëve të tilla, midis tjerash, na dëshmon edhe një shembull i tillë i botuem prej Thimi Mitkos qysh para 84 vjetëve.²² Vargjet e kësaj kange i gjejmë të rreshtueme si në prozë, pse, simbas gjasave, Mitkoja ka hetue tendencën e saj me përfundue në prozë. Motërzimet e kësaj kange i hasim edhe sot ndër popull, por shumë rrallë si kangë, më shpesh si kallxime popullore. Kjo na tregon se kjo poezi popullore me gjuetinë si motiv, i cili është jashtzakonisht i lashtë, ka përfundue në prozë, si ngjet edhe me disa kangë të tjera popullore, sidomos me legjendat tona dhe të popujve të tjerë.

2. Roli i kangës në bletarinë popullore

Me interes të veçantë për shkencë janë kangët e bletarit ose kangët e bletës me motive të punës në bletarinë popullore. Bletarët kanë hetue kaheerë ndikimin utilitar të kangës në bletë, prandej qysh moti si dhe deri më ditët tona shërbehen me te në punën e tyre. Kur bleta lëshon kah Shëngjergji ose në lāmë, bletari e ndjell amzën me kangë joshëse, përgëdhelëse, që të hyjë së bashku me bletët e veta në zgjue të ri, në shtëpinë e saj, si shihet në këta shembuj që po sjellim nga rrethina e Ferizajt:

1

Ritendo rubato



Mát, mát, mát, bí,
 Hajde hin drejt në shpí!
 Mát, mát, mát, bí,
 Mlidhi mizat kah i kí,
 Hajde hin drejt në shpí!²³

21 Kënduen Drita e Feime Shabani dhe grupi, më gusht 1960. Vërejmë se Toskët e Prespës e zbusin bashkëtinglloren rr prandej na tingllon fjala mar në vend marr. Njiherit vërejmë se në të folmet popullore të viseve të Kosovës, nga i sjellim kangët më poshtë, q-ja e butë shqipe është njaj-tësue me ç-në, kurse gj-ja — me zh-në.

22 Thimi Mitko, *Bleta Shqypëtare*, Skenderi e Misirit (Egjpti), 1878. Krah. ribotimin e saj në Vjenë, më 1924, fq. 29—30. Këte kangë e gjejmë edhe te Gj. Komnino, *Këngë popullore lirike*, Tiranë, 1955, fq. 15—16.

23 Të gjithë shembujt e kangëve të bletarit ose të bletës që po para-shtrojmë në këte punim, i kemi marrë nga rrethina e Ferizajt për dy arsye: 1.

Toni final i frazës muzikore të kangës s'epërme, i cili përkon me theksin e fjalës oksitone, bie një semiton dhe sajton hapin melodik të përbam nga sekunda e vogël, pra intervalin muzikor më të vogël. Ky rast paraqet shembull interesant dhe arkaik në pikëpamje melodike në gjiun e kangëve popullore shqiptare, prandej është me interes për studimet entomuzikologjike. Këte të zbritun të vogël të tingullit e kundrojmë të natyrshëm nga tendenca që shprehin tingujt finalë me rá më poshtë, ndoshta edhe nga arësyet fiziologjike. Si bie fjala, nga dobësimi i intensitetit të rrymës ajrore mbi kordet zanore të njeriut.

Mbasi procesi i punës në të zanunit e bletës, në kuadrin e bletarisë popullore, mund të zgjasi me orë të tana, si thonë bletarët „derisa bleta të joshet mirë”, ndihmësit e bletarit ose i tymojnë ose i stërpikin bletët me ujë që përmban mills (milcë) mbasi nuk ua kanda as tymin as shiun. Prandej bletari në kangën e vet ia përmend amzës shiun dhe me zâ joshës e lut që t'ikën dhe të shpëtojnë prej tij, natyrisht tue hy në zgjue, në konakun e saj të ri:

2

Perlando rubato



Mát, mát, mát, oj bí,
Hajde hin n'konak t'rí!
Po na bje ni ríq shí,
Po t'i lág kraht e rí,
E po t'lág me xhith thmí,
Po na lág mu e tý!
Mát, mát, mát, oj bí,
Mlidhi bijat kah i kí,
Hajde hin n'konak t'rí,
Mát, mát, mát, oj bí!

për ta ravizue sa më dukshëm procesin e punës në të ndjellunit e bletëve me kangë për në zgjue të ri, në këte trevë kahe të njoftun përkah bletaria popullore, dhe 2. për ta vù në pah sa më mirë ecuninë e zhvillimit të përmbajtjes dhe formës poetike-muzikore të këtyne kangëve të cilat paraqesin tip të veçantë në gjiun e folklorit shqiptar. Shembujt e tjerë të tillë që kemi mbledhë në trevat e tjera mbeten për t'u kumtue herëve të tjera.

Në këte shembull hapi melodik rritet në sekundë të madhe, me çka tregon tendencën për të zhvillue melodinë përkah ambitusi.

Në çastin kur nis amza me bletët e saj me iu afrue zgjoit, atbotë bletari i gëzuem që kanga e tij bënë efektin e duhur, u shton spontanisht intensitetin tingujve, madje, shqipton edhe vargje të rastit, fuqia shprehëse e të cilave mvaret nga aftësia individuale e tij. Me këte rast sidomos femnat paraqesin mjeshtri në të këndue- mit bletës, gjâ të cilin e përforcojnë me ndjenja të njoma dhe e zbu- kurojnë me ambëlshinë e zanit të tyne femnor. Mirëpo, nëqoftëse ble- tët nuk hyjnë drejt në zgjue, çka ngjet shpesh, por zanë vend në trupin e bletarit, ose i tubohen në fytyrë, atbotë ai nuk shqetsohet, i pakson mjaft lëvizjet në mënyrë që mos t'i ngacmojë se mund ta hanë, dhe kështu u këndon tue i përgëdhelë e dalëkadale i përcjell në zgjue. Kur ato mâ në fund hyjnë në zgjue, bletari i shoqnon me pasthirmë: Huuu... me të cilat e përfundon procesin e të zanunit (të vendosunit) të bletëve në zgjue me anën e kangëvet:

3

Parlando rubato



Mát, mát, mát, oj bí,
Hajde hin drejt në shpi!
Po vjen âma tuj flut'rú,
T'tâna blétt tuj afrú,
N'shpi të ré m'u rahatú,
Si zój shpije m'i sunú
Se pa âm s'mújn me rrnú,
Âm, âm, âm, oj bí!
Huuu...

Megjithëse edhe në këte shembull tingujt lëvizin mbrenda sekundës së madhe, prapsepap ata këtu tregojnë zhdërvjelltësi mâ të madhe ritmike se në të dy të parët që parashtuëm. N'anën tje- tër, në këte trevë folklorike (rrethina e Ferizajt) mblodhëm edhe kangën e bletës me melodi mâ të zhvillueme, e cila lëviz mbrenda kuintës së pastër dhe përfshin edhe vargjet e kangëvet të tjera të dhanuna mâ nalt:

4

♩ = 112



Mát, mát, mát, oj bí,
Hajde hin drejt në shpí,
Se po vjen në rig shí,
Po t'i lág kraht e rí,
E po t'lág me gjith thmí,
Po na lág mu e tý!
Hajt e bárdh, hajt e bú,
Hajde hin s'bân m'u tú,
Âm âm, âm, oj bí!

Mát, mát, mát, oj bí,
Mlidhi bijat kah i kí,
Hajde hin n'konak t'rí!
Po shkon âma tuj flut'ru,
T'tâna blétt tuj afrú,
N'shpí të ré m'u rahatú,
Si zój shpije m'i sunú,
Se pa âm s'mújn me rrnú,
Âm âm, âm, oj bí!

Kjo kangë, si duket, është sintezë e kangëve të bletës në rrethinën e Ferizajt dhe është më e re pse, në krahasim me të tjerat që dhamë më naltë, paraqitet më e zhvillueme si përkah melodias ashtu edhe më e plotë përkah përmbajtja.

Në shembujt e kangëve të bletës që dhamë na bien në sy tri elemente të qenësishme, të cilat janë gjithmonë të pranishme: 1. fjalët *mát*²⁴, *âm*, *bí* me të cilat bletari apostrofon bletën (amzën) e cila është objekti kryesor i vemendjes së tij; 2. fjalët që emnojnë zgjoin në mënyrë metaforike e metonimike: *shpí*, *konak i rí*, *shpí e ré*, të cilat kunorëzojnë qëllimin përfundimtar të krejt veprimit të bletarit; dhe 3. *vargjet e tjera ndërmjetëse* me të cilat bletari çfaq gjithë ate njomësi ndaj bletës puntore²⁵ të cilën e nderon dhe i flet

24 Sinonimet gjegjëse: *matkë*, *amzë*, *paricë* *parëzë*, *parëz*, *krah*. Fjaluer terminologjik serbokroatisht-shqip, Prishtinë, 1961.

25 Se çfarë vendi të randësishëm ze bleta në ekonominë popullore na tregojnë, përveç tjerash, edhe: Kanuni i Lekë Dukagjinit i cili përveç që të drejtën mbi bletën e trajton me paragrafet e ndryshme, ai i rregullon posaçërisht raportet shoqërore përkritazi me bletën, mjaltin, dyllin me §§ 199—212, kurse Kanuni i Skanderbegut bletës i kushton pikat 12—14 në kreun *Prona* dhe pikën 4 në kreun *Miku*. Krah. Kanuni i Lekë Dukagjinit, përmbledhë e kodifikue prej A. Shtjefen Konst. Gjeçov, O. F. M., Shkodër 1933; Kahreman Ulqini, *Gjurmime etnografike në trojet e Skanderbegut*, Buletin i USHT, ser. Shk. Shoq. 2/1961, fq. 182.

sikur t'ishte qenie e vetëdijshme dhe t'i kuptonte fjalët e tij.²⁶ Personifikimet dhe bisedat e tilla të njeriut tonë me miza, shpendë, kafshë, por edhe me gjana të ngurta dhe abstrakte, të cilat na paraqiten në shumë kangë popullore shqiptare, tregojnë lidhjen e ngushtë të njeriut punues me natyrën, të cilat reflektohen edhe në poezinë e tij. Kjo ligjshmeni i përfshin edhe, si do të shofim, objektet dhe mjetet e tjera të prodhimit që i përdor populli në punë.

Disa të dhana, të publikueme në kohë të fundit, pohojnë përdorjen aktive të kangëve të bletës në bletarinë popullore prej bletarëve shqiptarë të trevave të ndryshme. Kështu, Ramadan Sokoli boton tekstin dhe melodinë e një kange me të cilën Krajanja ndjell bletën për në zgjue të ri.²⁷ Qemal Haxhihasani na kumton vetëm tekstin e një kange të bletës nga Zadrime.²⁸ Mu kështu, pa melodi, tash vonë, Nadežda Pešić na dha tekstet e tri kangëve tri-vargjëshe të bletës në gjuhën shqipe, të cilat i këndojnë gratë shqiptare në katundet e Fushës së Prizrenit.²⁹ Materialet e tjera flasin mbi ekzistencën e kangëve të ngjashme edhe në mesin e bletarëve të grupeve etnike të ndryshme. Kështu, etnologia N. Pešić boton nga treva e njajhtë dhe tekstet e katër kangëve serbe të bletës.³⁰ Mandej, profesor Miodrag Vasiljević sjell tekstet dhe meloditë e dy kangëve të bletës, gjithashtu serbe (Pčelinje pesme) nga rrethina e Leskovcit.³¹ Kangë të ngjashme kemi pasë rasën me ndëgjue edhe ndër bletarë maqedonë dhe malazezë, por besojmë se kangët e bletës mund të gjinden edhe ndër popujt e tjerë të Ballkanit. Ndërkaq, interes të posaçëm për shkencë paraqet mënyra se si Vedasit primitivë të Cejlonit nxjerrin me anën e kangës mjaltin nga bletët e egra, të cilat me bā me kafshue njeriun — i sjellin vdekjen atypëraty. „Nxjerrësi i mjaltit” vedas ka hetue fuqinë magjike të kangës që ushtron në bletë, prandej tue këndue padā kangën kush-tue këtij procesi të punës, nxjerr mjaltin prej hojeve të bletëve të mëdha malore helmuese „bambara” dhe me anën e kangës shpëton nga rreziku. Pra, kanga u siguron Vedasvet rezultatet e punës në

26 Popullsia e rrethinës së Ferizajt bletën nuk e identifikon me kafshë dhe miza të tjera, pse jeton legjenda simbas së cilës ajo rrjedh nga trupi i Hazreti Idrizit. Prandej, mbasi kësaj i mveshin tipare njeriu, thonë: ka dék, diç (ka vdekë, vdiq) bleta e kurrresi: ka cōf, cofi (ka ngordhë, ngordhi) si thonë për kafshë. Ky nderim ndaj bletës jeton edhe ndër popullsinë e trevave të tjera të Kosovës. Madje, në Kolonjë, Nikaj, Mertur etj. „nuk bëjnë hashure me mjaltë se del nga shpirti i mizave; nuk duhet të shkelet uji që lajnë duart kur hanë mjaltë”, krah. Q. Haxhihasani, *Ekspedita folklorike e Kolonjës*, Buletin për Shkencat Shqërore, Tiranë, 1/1956, fq. 201.

27 Krah. Ramadan Sokoli, *Rreth kangëve të punës në folklorin tonë*, rev. Nëndori, Tiranë, 2/1955, fq. 120.

28 Krah. Gj. Komnino, vep. e cit. fq. 303.

29 Krah. Nadežda Pešić, *Pčelarstvo u Prizrenskom polju*, (Sela Novake i Lješane), Glasnik Muzeja Kosova i Metohije IV—V, Priština, 1959—1960, fq. 303.

30 Po aty, fq. 302—303.

31 Krah. Miodrag A. Vasiljević, *Народне мелодије Лесковачког краја*, Српска академија наука, посебна издања, књ. CCCXXX, Музиколошки институт, књ 11, Београд, 1960 fq. 68.

nxjerrjen e mjalit, që për ta paraqet burim jetësor.³² Kjo dukuni na dëshmon mbi karakterin e lashtë të kangëve kushtue bletës.

Këto të dhana na bindin se kangët e bletarit ose të bletës mbasi jetojnë ndër shumë grupe etnike, natyrisht me ndryshime të pakta ose të shumta, paraqesin landë folklorike të një randësie ndërkombëtare me shtrimje gjeografike të gjanë. Që të gjitha këto kangë të bletës presin të studjohen komparativisht gjithanshëm.

3. Puna në legjendat e murimit

Motivi i flijimit të grues në themel t'urës, kalasë ose të kishës në kangët tona legjendare, si ngjet n'anën tjetër edhe në legjendat e murimit të popujve të Ballkanit, (riti i flijimit të njeriut njihet edhe ndër grupet etnike t'Azisë dhe t'Afrikës) — në thelb i kushtohet mirëvajtjes së punës. Prandej mû në këto kangë, të cilat motivologjikisht i takojnë landës sonë folklorike mû të lashtë, na paraqitet puna si motiv. Që në fillim kanga ze fill me punën e tre vllazënve, të cilët orvaten me ndërtue themelin e ndërtesës:

5



Hej, tre Hasjân-e n'kâm-o jân çue,
T'tret-o vllazni, more, kokan çillue.
O nermje' veti-o jân besatue:
„Urën e Fshëjtit dôm me marue!”
O kan marr punen-o me punue,
O rrafsh tri vjet n'tâ kan punue,
Ka 'i kat zidin përdit-o tuj çue,
Dishka naten-o tu ja u rrxue!...³³

32 Krah. P. И Грыбев, vep. e cit. fq. 7—9; J. Andreis, vep. e cit. fq. 19.

33 Fragment i kangës *Ura e Fshëjtit* (në variantet e tjera: *Ura e Fshâjt*, *Ura e Shëjt*) që lidhet me urën mbi Drinin e Bardhë afër kat. Fshëj, Fshâj në rrethinën e Gjakovës. Kangën e sipërme e shënuem nga kangëtarët Salih e Feriz Krasniqi, kat. Drenovc i Malishevës, jo fort larg nga Gjakova. Disa motërzime të tjera të saj që i kemi shënuet në Gjakovë, Drenicë, në rrethinat e Pejës, Ferizajt në gegnishte, mandej edhe legjendën e murimit n'urë në tosknishte me tri zane në kat. Nakolec të Prespës nga Zekman Islami, Gani Mehmeti dhe grupi — që të gjitha këto tregojnë përhapjen dhe të këndue-mit aktiv të legjendës së murimit n'urë edhe sot e kësaj dite, ndër popullsinë shqiptare. Le të krahasohen edhe këto burime: Гл. Елезовић, Три арнаутске варијанте мотива о зазиђавању невесте, Зборник лингвистичких и филолошких расправа А. Белићу, Београд, 1937, fq. 391—398; *Kangë popullore shqiptare të Kosovës e Metohis*, bleni i parë, Prishtinë, 1952, fq. 15—20; *Këngë popullore legjendare* nga Q. Haxhihahani, Tiranë, 1955, fq. 3—19; R. Sokoli, vep. e cit. fq. 116—117.

„Forcën mbinatyrore” të shprehun në vargun e fundit, ata „e zbusin” dhe „e përvehtësojnë” me flijimin e bashkëshortes së vllaut më të vogël besnik, e cila atë ditë u sjell drekën. Mbi gjakun e kësaj nane me djalë për gjini ngadhnjen puna e njeriut — ngritet themeli i godinës dhe së bashku me te agon jeta e re, frytet e së cilës i kush-tohen bashkësisë dhe vetë djalit të saj. Këte flijim të njeriut, të pasqyruem në kangët e murimit të grues në Kalanë e Shkodrës, Gëteja e vlerësoi si shembull të „ndjenjave barbare” mbasi u njoht me përmbajtjen e kangës serbe „Zidanje Skadra”.³⁴ Përkundrazi, ky motiv në të vërtetë godit në mënyrë më t’ashpër këto „ndjenja barbare”, pabesinë e të dy vllazënve më të mëdhaj, vetë pozitën e nënshtrueme të grues, kurse n’anën tjetër, ravizon etikën e naltë altruiste të femnës, e cila therorizohet në mënyrë të vetëdijshme me qëndrim stoik nga shtytjet më fisnike: me i dhurue vehten mbarëvajtjes së punës, me ndikue në jetën e ardhshme edhe mbas vdekjes, me ushqye brezin me gji të nguruem, kurse të verbëve me ua rikëthye të pamunit. Ky detal i vrazhdë n’altarin pagan, vërteton vendosmërinë e njeriut që me çdo kusht, qoftë edhe me flijimin e vetë njeriut, ta bájë medoemos punën ngadhnjyese, këte nxitëse kryesore të përparimit të shoqnisë njerëzore.

Në vetë melodinë e sipërme hetojmë se kangëtari shpreh dhimbjen ndaj flijimit të protagonistes së re, prandej zani i tij, nën ndikimin e ndjenjes psikologjike të ndrydhun që përjeton, endet mbrenda kuartës së pastër. Por, kur ai ravizon flijimin e saj të ndërgjegjshëm dhe qëndrimin besnik e burrnor të të shoqit, atbotë zani i tij bëhet dramatik, ngritet dhe zgjanon ambitusin e kangës deri n’oktavë.³⁵

Asht interesant se flijimi simbolik në shenj të mirëvajtjes së punës ruhet aty-këtu ndër popullsinë shqiptare edhe në ditët tona. Ngjan që bujqt kosovarë në rrethinën e Ferizajt, të Gilanit, në Drenicë, Llap etj. para se me nisë me mbjellë grunin prej një gjel (preferohet të jetë i bardhë çka ndjell dhe simbolizon fatbardhësinë në të korrat e ardhshme) dhe me gjakun e tij stërpikin farën e dritit, umbin ose plorin e plugut ose parmendës. Me këte akt ritual ata ndjellin të korra të begatshme. Natyrisht, nën ndikimin e kushteve të reja shoqnore, kjo dukuni e lashtë është në humbje e sipër, madje vende-vende është qitë krejtësisht jashtë përdorimit.

4. Kangët me motive pune nga blegtoria

Blegtoria si degë e randësishme e ekonomisë popullore është reflektue mjaft mirë në brumin poetik t’artit popullor. Nji numër i madh kangësh dhe i improvizimesh instrumentale me fyell, pëlqesë

34 Krah. Војислав Ђурић, *Антологија народних јуначких песама*, Београд, 1954, fq. CII, 29—35.

35 Variacionet melodike dhe kadencën e kësaj kange do t’i japim një herë tjetër.

(binak), kavall, gajde... janë të lidhuna me motivin e punës nga blegtoria, e sidomos nga jeta baritore. Bariu i këndon me kënaqësi deles rude që t'i dhurojë qingj të butë, kurse mjelcorja (mjelgusha) i drejtohet me kangë përgëdhelëse deles, lopës mjelëse tue e urue dhe bekue si nana fëmijën, që t'ia mbushë vedrën, kusinë me tam-bël. Mirëpo, puna e ruejtjes së bagëtive dhe punimit të bylmetit na paraqitet si motivi kryesor me anën e të cilit barijt shprehin dashurinë ndaj bareshave dhe baçicave (stanareve, grave që punojnë bylmetin). Janë karakteristike dialogjet, natyrisht edhe t'idealizueme nga vetë kangëtarët, midis barijve dhe bareshave ose barijve dhe mjelgushave, si shihet edhe nga kjo kangë shënue në rrethinën e Ferizajt:

6



— Oh, ku ke Rrushe, oh, kur çita púshk-e?
 — Oh, kesh tue mjelën, oh, delmen rogúshe.
 Delmen rogúshe, oh, delmen bardhóke,
 Oh, u habita, oh, e mjela n'tók-e.
 Oh, m'i zún syt-e, oh, kto t'shkretat flók-e.
 Çeto flók-e, tha, oh, flókt e gata,
 Oh, merrmi nân-e oh, çitmi, bre, mrapa!
 Çitmi mrapa, oh, çitmi në shpín-e,
 Ta shoh sherrin, oh, në çat ledín-e,
 Kah p'e shpráz-e oh, bre çat alltín-e!

Në një numër kangësh të tjera këndohet lufta e barijve për mbrojtjen e bagëtive që ruejnë, të cilët edhe vdesin tue mbrojtë burimin e jetës së vet. Nji shembull të tillë, të thurur poetikisht prekshëm nga kangëtar i anonim, paraqet *Kanga e Selman Likës* (këndohet edhe *Litës*), e cila ka shumë variante, madje një më të plotë e shënuem nga kangëtar i mirë *Rizah Bllaca* nga Bllaca e Suharekës. Selmanit i vdesin të dy djemt në ditën e martesës së tyre në ndeshje me hajdutë që u kishin rá dhenve t'ua rrëmbejnë, dhe kur ai i piklluem i thërret të dy nusët me ua kumtue këte lajm tragjik që të këtihen në shtëpi kah kishin ardhë, ato i përgjigjen:

Zoti t'pjékt, báb, me ta n'xhenët-e!
 Shycyr n'marre s't'u kan xhét-e,
 Po kan dék-e për máll te vèt-e!
 Për ket pún, báb, hiç mos ki dèrt-e,
 Se s't'i lám-o çylernat shkrèt-e! etj.

Këte sakrificë të nuseve të cilat nuk ia kërkojnë shpinën vjehrrit të ngashryem, por mbesin vullnetarisht për djemt e tij në djep, poeti popullor e vlerëson si fisnik dhe mirënjohje ndaj vdekjes së ndershme të burrave të tyre të padestinuem, rá në mbrojtje të pasunisë së fitueme me punë. Madje, arësyen e përhapjes së kësaj kange t'adhurueme, e gjejmë në motivin e saj që mbështetet n'etnopsikologjinë dhe zakonet e popullsisë shqiptare.

Në mënyrë të veçantë janë interesante kangët që thuren rreth karvajave, që e damë me i quejtë *kangët e karvajave* ose *kangë karvajash*, të cilat paraqesin bukur rezultatet e punës së popullsisë blegtorale. Kangë karvajash hasëm në viset e Metohisë, nga të cilat inçizuem në shiritë magnetofonikë që nga Istoku e Gjurakovci, e sidomos në katundet e Vokshit deri në Junik, pra në rrethinat e Pejës dhe Gjakovës, vise këto që njihen si më karakteristike në Ballkan në pikëpamje t'ekzistencës edhe sot e kësaj dite të bashkësive të mëdha familjare.³⁶

Kjo dukuni specifike në rregullimin shoqnor ka sjellë me vehte edhe landë folklorike të veçantë, si paraqesin kangët e karvajave të cilat përshkruejnë jetën dhe punën e një pjese t'antarëve të këtyne bashkësive të mëdha familjare, që kujdesen për bagëtinë dhe bylmetin. Aty kah Shëngjergji barijt së bashku me fëmijët dhe baçicën nxjerrin bagëtinë (zakonisht dhent) në kullosa të bjeshkës dhe atje në stane (tëbana) i ruejnë me kujdes dhe gjithë verën mbledhin bylmet. Në vjeshtë, një javë para se të zbresin në shtëpi, e tundin mazën grumbullue në tinarë dhe prej saj nxjerrin tëlyen. Në këte kohë, për ne me interes, fëmijët e barijt e rij që gjinden aty këndojnë dhe imitojnë tunen e bylmetit, prandej na tingillojnë fjalët onomatopeike *tuna-tuna* në vargjet e kangëve të karvajave. Tash ata këndojnë me kënaqësi për karvajat që do të vijnë mbas një jave me kuaj, gomarë në rresht, në formë karvani, të cilët do t'u sjellin rrobe të reja, ato më të bukurat, dhe do t'i marrin me vehte në katund ku do të takohen përsëri me pjestarët e tjerë të familjes që kanë pasë mbetë në shtëpi për të krye punë të tjera. Kangët e tyre pasqyrojnë kënaqësinë që ndiejnë ata mbas punës së kryeme me sukses, frytet e së cilës do t'i gëzojnë bashkarisht me farefisën, pra çfaqin ndjenjën e kolektivitetit, çka është karakteristike në bashkësitë tona të mëdha familjare, por edhe në familjet e tjera të katundit shqiptar në përgjithësi. Të gjitha këto pasqyrohen, si na ven në dukje kjo kangë karvajash nga kullosat e Drenovcit, që po e sjellim në tanësi:

36 Krah. Dr Mark Krasnići, *Šiptarska porodična zadruga u Kosovsko-Metohijskoj Oblasti*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije IV—V, Priština, 1959—1960, fq. 140.

7

$\text{♩} = 104$

O tu na tu - na e va - ja . va - ja

O sod ni jáv na vín kar - va - ja!

cadenza
Jí — ja ooó! Uú — va ooó!

O tuna-tuna e vaja-vaja,
 O sod ni jáv na vín karvaja!
 O vín karvaja varg e ví,
 O sikur dhënt në ruseli,
 O vín karvaja vija-vija,
 O na-i bin teshat në shamija,
 O sod ni jáv shkójm te shpija,
 O vín karvaja si zamoní,
 O veton tirja, kllapedoní!
 Í ja ooó — Í ja ooó!
 Uú va ooó — Uú va ooó!

Eu vín karvaja tân tuj knue,
 O n'guri t'nuses me pushue,³⁷
 O buk me hângër — me tfillue,
 O sa ma shpejt teshat m'i prue,
 O nesër natje n'shpí me shkue,
 E kur të dalim te dera e stanit,
 O tymyrmeç, moj, maja e malit!
 E kur t'shkójm na te shpija,
 O gzohen pleçt e gzohen thmija.
 O ne na dalin nanat para,
 O plot pshtjellákt molla e dardha.
 O prehet dashi — prehet dhija,
 O zihet mishi n'haranija,
 O piçet pitja në tepsija,
 O zihet maza në kusija,
 O thrrasim miç e thrrasim bija,
 E knójm káng me çitelija,
 O tak e tuk kërset alltija,
 A há, se karvaja erdh te shpija!
 Í ja ooó — Í ja ooó!
 Uú va ooó — Uú va ooó!

Nga landa poetike dhe muzikore e kangëve të karvajave kuptojmë se kemi të bájme me një tip të veçantë kangësh popullore shqiptare, që nuk i kemi hasë te grupet e tjera etnike me gjithë interesimin tonë. Kangët e karvajave këndohen edhe në një mënyrë të veçantë si është rasti me shembullin tonë që dhamë:


³⁷ Guri i nuses quhet një gur natyral me madhësi 2 m² në bjeshkë të kat. Strelle, ku pushojnë karvajat dhe njerëzit e tjerë.

kangëtari (zakonisht fëmijët ose bareshat) me gishtin e madh të dorës dridhin arrëzën e fytit dhe me anën e zanoreve në fillim dhe në fund të vargjeve na japin një glissando interesant, e sidomos tingujt interjeksionalë të kadencave jehojnë fuqishëm dhe shkojnë tue u përhapë shumë larg në hapsinën e natyrës, çka len efekt akustik të posaçëm. Madje, fëmijët bëjnë gara se cili prej tyre mundet me e dridhë zanin sa më mirë, sa më fuqishëm, sa më kandshëm.

Nën ndikimin e raporteve të reja ekonomike-shoqnore, kur bashkësitë e mëdha familjare dhe familjet e tjera në katund pësojnë ndërrime të thella, kangët e karvajave janë në humbje e sipër pse edhe vetë puna e tillë ka ndërrue, e barijt gjejnë mënyra të tjera argëtimi, derisa një ditë të mos mbesin në letër si dëshmi e kohës së kalueme.

Në relacione me jetën baritore në kullosa verore, prej nga i kemi kangët e karvajave, na paraqiten edhe disa kangë të tjera që shtjelojnë motivin e punës. Vajzat-baresha, por edhe fëmijët, ndahen prej kopesë së dhenve dhe bredhin nëpër bjeshkë për të mbledhë boronica, dredhëza, mjedra etj. Tue u këthye nga kjo punë mbledhësit këndojnë (në grup ose solo) në mënyrë krenare dhe u kumtojnë baçicavet rezultatet e punës:

8



Oj baçica,
A po doni,
Boronica?
Borovaça?
Hiç kërkujna,
Mos ja dhaça!
Vetit e detit,
Nan's Mehmetit,
Mehmetit Alís,
Brinit dhís,
Auuú...

Tingulli final i vargut në takt bie vazhdimisht për një kuartë të pastër, përveç në taktin e dhetë, ku për mungesë të një rrokjeje humb tingulli c'. Në shembullin e ardhshëm ritmi dhe melodia tregojnë zhërvjelltësi pak më të madhe se në të kaluemin. Tash tingulli final i vargut në takt bie në kuarta dhe në kuinta të pastërta, pra shkon tue u zhvillue ambitusi i kangës:

9

♩ = 80



Ani oj baçeza,
A po doni dredhza?
— Dredhza nuk po due,
Pite me t-hollue,
Çiken me martue,
Te burri me çue!
Auuú...

Si shihet, të gjithë shembujt e kangëvet të mbledhësve të fryteve mbarojnë me tinguj interjeksionalë, të cilët luejnë rolin e kadencave në të përmbyllun të kangës. Në kangët e tjera të tilla mbledhëset i drejtohen me vargje baçicës që ta ushqejë çobanin, e nëqoftëse nuk kujdeset mirë për te, atbotë e mallkojnë. Ndonjeha nga kangëtarët krenohet që ka mbushë shportën me dredhëza, boronica (burenica), mjedra... dhe tue këndue me gisht n'arrëz të fytit, si në rastin e kangës së karvajavet № 7, i përqesh shoqet që nuk kanë mbledhë sa ajo:

A, musha krojshen po shkoj n' stân-e,
A, t'tâna shoqet i lash n'mâl-e,
A, i lash n'mâl-e ner ni kersh-e,
A, tuj piskât sikur ni dreç-e,
A, sikur dreçi në gastare,
A, si laruka me cingâre!
Ií ja ooó — Ií ja ooó!
Uú va ooó — Uú va ooó!³⁸

Mirëpo, po që se këtyne vargjeve me krahasime shpotitëse u përgjegjet ndonji vajzë tjetër me vargje të tjera, gjithashtu the rrëse, çka ndodh shpesh, atëherë midis tyre lind dhe zhvillohet një duel poetik dhe muzikor, gjatë të të cilit sajohen vargje atypëraty nga të dy palët, si me qenë ndonji ndeshje poetike-muzikore Agon-mousicos, të kohës së Grekëve të Vjetër. Ja edhe një rast ku femna shqiptare sprovon aftësitë e veta në gjiun e krijimtarisë poetike.

38 Që të katër kangët e fundit i shënuem gjatë vjetëve 1959—1961 nga barijt dhe bareshat në kullosat e Drenovcit të Vokshit, në rrethinën e Deçanit, ku na drejtoi mësuesi i vyeshëm Rrustem Binakaj nga Drenovci, kurse e ama e tij, Hatë Binakaj, 68 vjeçare e cila ka kaluar 30 vëra me dhen në bjeshkë, e 18 vjetë ka qenë baçicë, na ndihmoi mjaft në punë me informatat e hollësishme.

5. Kangët me motive pune nga bujqësia

Nji numër kangësh tona popullore shtjellojnë motive pune nga bujqësia. Në Kosovë kemi mbledhë material folklorik mbi mënyrën e fshimjes primitive të drithit. Kështu, duejt me drithë vendoseshin në lāmë rrethepërqark mullarit, rreth në cilit sillej kafsha e trashë shtëpiake e lidhun me litar, që tue i shkelë shkundte kokrrat nga kallijt. Me këte rast bujku cytte kafshën me zâ të naltë që ta shpejtojë vrapimin, dhe shqiptonte vargje të tilla:

*O xhok, bre,
Bîr, bre,
Sillu, sillu!
Hajt merre te mullári,
Çite drejt te hamári,
Hajde, bîr, bre,
U-ha-ha-há!...*

Por kur në vend të gjokut qëllonte doriu, atëherë bujku i drejtohej edhe me vargje të tilla:

*Oj dori, morí,
Hajt, bí, morí!
Sillu pa pritue,
Se bashk kem' me shkue,
N'mullí për me blue,
Pa mull s'mújm me rrnue,
Hajde, bí, morí,
Sillu, sillu,
U-ha-ha-há!...³⁹*

Në këto vargje me rimë të puthun, në të cilat ngritet dhe ulet prorre zani, hetojmë elemente themelore të kangës, të cilat bujku tue i trashëgue prej të parëve të tij i improvizon atypëraty gjatë procesit të punës. Ky recitativ eufonik dhe euritmik na ban me e dallue këte krijimtari poetike të rastit të bujkut nga britmat dhe biseda e zakonshme.

Kjo gjâ ndodhte atëherë kur s'kishte maqina fshimëse, por në disa vise malore të shmangëta dhe të vorfëna të Kosovës nji punë e tillë praktikohet deri në ditët tona, prandej edhe kanë jetue vargje të tilla t'improvizueme. Në dy shembujt e sipërm hetojmë se bujku tue i theksue fjalët: hambar, mullí, miell, në të vërtetë, ndjell mbarësi ekonomike, vetí kjo karakteristike e kangëve të tjera (kangët e motmotit) të lidhuna me punën e tij dhe të blegtorit. Mirëpo, në gjiun e kangëvet popullore shqiptare bashkëkohore thuren vargje rreth maqinavet fshimëse, korrëse, lidhëse dhe të tjera, të cilat si mâ produktive, po i zavendësojnë gjithnji e mâ tepër mjetet e tjera primitive të punës në katund. Kemi mbledhë nji sasi kangësh darsmore, në të cilat tue këndue me def, vajzat

39 Të dy shembujt i shënuem nga Halil Haliti, bujk 50 vjeçar nga kat Sherret i Ferizajt, i cili na rekonstrukttoi këte proces të punës primitive dhe na informoi hollësisht në lidhje me te.

shprehin kënaqësinë dhe krenohen që kanë mjete teknike të tilla. Me anën e kësaj kange, të marrim vetëm një shembull nga rrethina e Ferizajt, vajzat nxitojnë me i kumtue nuses, të cilën e shquejnë simbolikisht fillanzë, se punët e fushës i kryejnë me maqina, prandaj i paralajmërojnë jetën e begatshme dhe të lumtun që e pret në vend t'asaj me mundime fizike dhe skamje si përpara:

10



Flut'roj fillânza e na rá n'tërshân-e, o,
 Si te na, lulí, kër-kun s'un xhân-e, o!
 Pës maqina i kena n'aborr-e, o!
 Ani një me fshi e një me kórr-e, o.
 Ani një e kena lara-lara, o,
 Ani për me-i mlédh dujt nepër ara, o.
 Ani një e kena me tel t'trash-e, o,
 Ani për me fshi e me lidh kásht-e, o.
 Edhe një e kena me tel t'zi-e, o,
 Për me çue me tá grún n'mulli-e, o,
 Mos me shkue mâ me kerr me kije, o!⁴⁰

Të thururit e disa teksteve me përmbajtje të ndryshme tue pasë si bazë një model muzikor popullor, paraqet ligjshmeni në folklorin shqiptar, si ngjet, madje, edhe te popujt e tjerë. Por, kanga e sipërme paraqet provë të kundërt, që ndodh mâ rrallë. Kangëtarët e njajta pa ndryshue tekstin na dhanë variantën e melodisë së saj me lëvizje melodike mâ të qeta, por gjithashtu mbrenda kuartës së pastër:

10a



Ky rast shpreh begatinë melodike të visarit popullor të këtij visi të panjoftun në folkloristikën tonë.

Shembujt e kangëvet rreth fshimjes së drithit në mënyrë primitive, në të kaluemen, dhe të kësaj bashkëkohore me mjete

40 Këte kangë me të dy variantet e melodisë e shënuem në një darsëm në kat. Sazli, Ferizaj, më 1960.

teknike moderne, që vumë në pah, paraqesin edhe një dëshmi mbi ligjshmeninë që kangët sajohen dhe ndërrohen krahas me paraqitjen dhe ndërrimin e mjeteve të prodhimit.

N'anën tjetër, funksioni i kangës ndihet edhe në punët e tjera bujqësore. Kur bujku është tue korrë, kositë, prashitë këndon më vehte ose me zâ të lehtë, por kanga edhe i shpërthen nga gjoksi me gjithë fuqinë që ka. Ai me këte kangë shpreh të bukurit që ndien kur vegon frytet që do të sjellë puna. Këte ndjenjë të fuqishme ai e përcakton dukshëm tue ravizue punën që ban së bashku me të zgjedhunën e vet, pse ndërsa ai nget qetë — ajo hedh farë, frytin e së cilës me të korrë, të fshiem, gjithnji bashkarisht, do ta hanë me faqe të bardhë.⁴¹ Por, kur korrësit bashkohen në punë, atbotë buçet kanga e korrjes, tingujt e së cilës rrisin vrullin dhe mbajnë gjallë ndjenjën e haresë në punën kolektive. Por, kanga e korrjes di të bâhet edhe nxitëse e garavet në punë. Kështu, ndodh që korrësit dhe korrëset, të rreshtuem në dy grupe, thërrasin antarët e tyre me anën e vargjeve të kangës që t'i bashkojnë forcat dhe të shpejtojnë në punë, për ta krye sa mâ parë dhe në mënyrë shembullore korrjen e pjesës së tyre, me ç'rast kanga e shpejtëson procesin e punës.⁴² Ndërkaq, korrëset këndojnë me kënaqësi kangën e grunit të bardhë që do t'i mbushë hambarët, misrit që do ta shpërblejë shumëfish mundin, si shihet në këte kangë mbledhë në Drenicë:

11



Mora drapnin me shku n'ár-e,
Of, amon-e,
Mora drapnin me shku n'ár-e.

Për me kórr-e drith të bárdh-e,
Of, amon-e,
Për me kórr-e drith të bárdh-e.

Në at ár-e është ni dárdh-e,
Of, amon-e,
Në at ár-e është ni dárdh-e.

Në at dárdh-e 'i pllum i bárdh-e,
Of, amon-e,
Në at dárdh-e 'i pllum i bárdh-e.

More pllum-o kriht me lloç-e,
Of, amon-e,
More pllum-o kriht me lloç-e.

Na u mush ara kallamoç-e,
Of, amon-e,
Na u mush ara kallamoç-e. etj.⁴³

Si në këte kangë ashtu edhe në disa të tjera që përshkohen me motiv pune nga bujqësia, figura e femnës sonë paraqitet e

41 Krah. R., Sokoli, vep. e cit. fq. 120.

42 Le të shihet një kangë e tillë nga kat. Fraskanjel, rreth i Cetinës Mal i Zi, në përmbledhjen Folklori muzikuer shqiptar, bleni i dytë, nga Lorenc Antoni, Prishtinë, 1961, fq. 24.

43 E shënuem nga vajzat e kat. Krushevc, Drenicë, më 1957. Nji variantë të kësaj kange e shënuem në kat. Sazli të Ferizajt.

zellshmë me mjete të punës në dorë, zakonisht me drapën ose shat. Karakterin e saj të punës na zbulon bukur një kangë mëngjesore: ajo ngrihet pa dalë drita dhe zgjon bujkun, natyrisht të dashtunin, me një kovë ujë pusi, që e thërret për me shkue fill në punë:

... Merre drapnin ja t'shkojm' n'arë,
 çou o çun o se ke punë
 Se t'korrim uriz të bardhë,
 çou o çun o se ke punë
 Se t'a ham o të dy bashkë,
 çou o çun o se ke punë.⁴⁴

Në këte kangë që le përshtypje si obadë, që i hasim mâ rrallë në folklorin shqiptar, vërtetohet dëshira e të dashnuemve që të ngrisin jetën tue u mbështetë në djersën e vet, frytet e së cilës do t'i gëzojnë bashkanisht, ndjenjë kjo që përshkon shumë kangë dashunie. Kangëtari ynë nga gjiu i popullit, si shohim, i vlerëson femnat e tilla si ideale në jetë prandej i merr për protagoniste në kangët e tij të dashunisë, pse ai i identifikon konceptet e punës dhe të dashunisë. Prandej në poetikën e tij korrësja e refuzon ndihmën e plakut të paafitë, kurse ate të të riut e pranon me kënaqësi, pse risia është koncept korelativ me dashuninë dhe veprimtarinë e njeriut, dhe mû përmes procesit të punës së përbashkët tue u rritë efekti i saj përftohet gradacioni në dashuninë midis këtyne dy të rijve:

12

$\text{♩} = 10\frac{1}{2}$

O dül syze, o me kórr n'ár-e, Tek po vjen-e ni plák drumtár-e.
 Puna már, oj syzéz e bárdh-e!
 Te már paç, more, plák drumtár-e!
 T'ví, syzezó, me t'nimú pák-e?
 Nihma jote, plák, u láft me xhàk-e!
 Po shkon plaku o tuj menuë:
 „Ç'dreçi m'çojke, tha, me fól mue?!“
 Tek po vjen-o ni djál drumtár-e,
 Puna már, oj syzéz, e bárdh-e!
 E t'már paç, djál, ti pllum i bárdh-e!
 T'ví, syzezó, pak me t'nimue?
 Nihma jote, djál, kóft bekue!
 Ka rrók drapnin djali n'ár ka shkue,

O, dül syzeza, o me kórr n'ár-e,
 Tek po vjen-e ni plák drumtár-e.
 — Puna már, oj syzéz e bárdh-e!
 Te már paç, more, plák drumtár-e!
 — T'ví, syzezó, me t'nimú pák-e?
 — Nihma jote, plák, u láft me xhàk-e!
 Po shkon plaku o tuj menuë:
 „Ç'dreçi m'çojke, tha, me fól mue?!“
 Tek po vjen-o ni djál drumtár-e,
 — Puna már, oj syzéz, e bárdh-e!
 — E t'már paç, djál, ti pllum i bárdh-e!
 — T'ví, syzezó, pak me t'nimue?
 — Nihma jote, djál, kóft bekue!
 Ka rrók drapnin djali n'ár ka shkue,

44 R. Sokoli, vep. e cit. fq. 121.

Kan marr punën mir-o me punue,
 Ka nis rëni, besa, m'u ngushtue,
 Krye për krye të dy jân afrue,
 Kan marr llafin, o shkójn tuj llafue:
 — A m'je fól, djál, a m'je martue?
 — As s'jâm fól, syzéz, as s'jâm martue.
 — A ta jap, djál, ni tëme més-e?
 — Pse me marr-o çyçen e zéz-e?!
 — A ta jap, djál, ni tëme motër?
 — Oj ty t'mét syzéz, kërcú në votër!
 Shka po ma çet, syzéz, kodër m'kodër?!
 Kodër m'kodër shka po ma çet mue,
 Hiç ma t'mir, syzéz, se ti s'e due!
 Hej, more, e kâm çefin-o, hoj,
 Hej, more, ty me t'márr, ani-o, hej!⁴⁵

Kangët që po sjellim, por edhe ato të tjerat të ngjashme të letërsisë sonë popullore, pasqyrojnë punën dhe, në raporte me te, gjendjen ekonomike të masave punuese fshatare, e sidomos pozitën shoqnore të femnës sonë. Në kushte historike të papërshtatshme e shfrytzueme nga pronarët feudalë dhe kapitalistë, popullsia bujqësore shqiptare e themelonte gjallimin e saj në mjetet e prodhimit mjaft të dobëta. Ajo tokën e lavronte me mjete primitive të punës, të cilat kryesisht i siguronte vetë.⁴⁶ Në të tilla kushte jetësore të vështira, kur njerëzit punues rrekeshin me mish e shpirt t'i plotësojshin nevojat e veta më elementare, grueja jonë, përveç punës që bante në fushë, mirrte e punonte mbrenda në shtëpi që të prodhonte sa më tepër ushqim për mbarëvajtjen e familjes, si shihet edhe në këte kangë që i drejton tpinit gjatë procesit të punës:

13



Tunu tpi-e, u tunsh i bárdh-e,
 Rritnaj kokrren sa ni dárdh-e!

Háe t'mira do t'marójm-e,
 U çójm burrave çì livrójm-e!

Tunu tpi-e, rrum e bùm-e,
 Çitnaj tunën sa ni cùng-e!

Tunu tpi-e, paç nafák-e,
 Se na jena kallabllák-e!

T'mádh e t'vogël me na ngie,
 Se s'un vrrójm-o na pa tye! ⁴⁷

⁴⁵ Këte kangë të këndueme nga kangëtarët e mirë Salih e Feriz Krasniqi, e sjellim në tanësi mbasi na paraqitet si motërzimi më i plotë për kah poetika e saj në krahasim me variantet e saj të tjera që i njohim në literaturën e poezisë sonë popullore.

⁴⁶ Krah. Ali Hadri — Milan Perkaj, *Pasqyrë e historis nacionale shqiptare*, Prishtinë, 1960, fq. 49—50, 68—72, 97—98 etj.

⁴⁷ E shënuem në kat. *Sherret, Ferizaj*. Disa motërzime të kësaj kange që i kemi ndëgjue në rrethinat e Kaçanikut, Shtimjes, Lipjanit, Gilanit, Priz-

Kjo grue këndon po me këte melodi vargje të tjera kur përpush zjarrin, prej të cilit kërkon në mënyrë imperative që të ndizet me vrull (kapullúr), pse bujqit t'unshëm presin mbas pune laknorin e pjekun:

13a

Kallu zjerm-e, kapullúr-e,
Ta çet dada ni laknúr-e,

Ni laknúr-e sa ma shpëjt-e,
Se po pritën nizet vét-e!

Nizet vét-e jan untue,
N'ara ditën tuj punue! 48

Kur kjo grue u përgatit bujqvet mëngjesin, në vend të drekës, si pamë më nalt, atbotë edhe kanga e saj merr vargje të reja, të cilat paralajmërojnë punën e tyre gjatë asaj dite. Mirëpo, me këte rast, si do të shohim, melodia e saj ndryshon. Në vend që ta zhvillonte në sekstë të madhe si në shembullin 13^a (le të shihet shemb. muz. № 13), ajo tash e ngushton ambitusin melodik për dy gradë, pra e end mbrenda kuartës së pastër:

14

$\text{♩} = 88$ (Ad libit)



Kallu zjerm-e, kapullúr-e,
Ta çet dada ni laknúr-e!

Jan tue pritën nizet vét-e,
Dón me shkue n'pún ma shpëjt-e.

Ky laknuri pét për pét-e,
Jan tue pritën nizet vét-e.

N'pún ma shpëjt-e dón me shkue,
Nepër ara me punúe.

Me punúe hiç pa u nál-e,
Për me korrën grún të bárdh-e. 49

Në landën poetike-muzikore të tre shembujve të mbramë hetojmë dy dukuni të kundërta: 1. shembujt № 13 dhe № 13^a kanë një melodi të përbashkët me ritëm në 4/4 dhe dy lloj tekstesh për-kah përmbjatja që këndojnë dy procese të ndryshme të punës, dhe 2. shembujt № 13^a dhe № 14 kanë dy melodi me ritme të ndryshme në 4/4 dhe 5/4, të cilët këndojnë një proces të njajtë të

renit tregojnë ekzistencën e një veprimtarie poetike të tillë të femnës sonë në disa treva folklorike.

48 E shënuem në kat. Sherret, Ferizaj.

49 Po aty.

punës. Ky material i folklorit muzikor e poetik shqiptar dhe vrojt看met tona përkojnë me shqyrtimet kritike që i ban shkenca bashkëkohore hipotezës së njanshme të Byherit rreth t'ashtuquejtunavet „kangë të punës”, mbi çka dhamë një vështrim të shkurtë në ballë të këtij punimi.

Shembujt e tjerë të kangëve popullore shqiptare që e ndryshojnë ritmin simbas rastit dhe vendit ku këndohen, konfirmojnë këto vrojt看me të sipërme dhe na bindin edhe ma tepër që kangët të cilat këndohen në punë nuk kanë plotësisht ritme dhe melodi të kristalizuese. Le të marrim kësaj here vetëm një shembull të tillë: shatorët Krajanë tue mihë misrin këndojnë një kangë të cilën e përdorin edhe për vallzime; mirëpo me rastin e mihjeve ata ia përshtasin jonen e kangës simbas ritmit të punës:

*Po shkon djali n'rrogë me 'i vashë,
Për një dele një motmot,
Si u mbush-o ai motmot,
Djali lypi rrogën-o... 50*

Asht interesant se kjo kangë që flet mbi dashurinë e një bariu me vajzën e të zot të kopesë, me motiv mjaft të lashtë (rrog-tari shpërblehet në natyrë: Për një dele një motmot) ka edhe motërzimin mjaft t'afërt në mezin e poezisë popullore t'Arbëreshëve t'Italisë:

*Mbeta mot e mot me rrogë,
Për një kjegjëz të mundafshhtë,
Por sa bëra mot e monë,
U i lipa kjengjözënë... 51*

Vjetërsia e kësaj kange të cilën e këndojnë edhe sot Arbëreshët e Italisë pesë shekuj mbas shpërnguljes së tyre nga atdheu i hershëm, i shton aq më tepër vleftën këtij shëmbulli që provon luhatjen ritmike të një kange tonë popullore kur këndohet në raste të ndryshme.

Shumë materiale folklorike të tjera na flasin, gjithashtu, mbi punën e femnës sonë fshatare si mbrenda ashtu edhe jashta shtëpisë. Kjo vjen nga vërtetësia pse përveç detyrës së saj në mkambjen e brezit dhe të punëve të saj shtëpiake, ajo edhe pjesëmarrjen direkte në prodhim jashta shtëpisë e kundron si gjë krejtësisht normale. Prandej femna jonë fshatare në saje të punës së vet jashta shtëpisë i siguroi disa të drejta elementare, si është të dalunit e lirë e jo me përcjellje nga ndonji antar i familjes si ndodhte në qytet, ku femna qytetare nën ndikimin e islamizmit qe mbyllë në çarshaf, pra në shtëpi, tue u izolue nga jeta publike dhe

50 R. Sokoli, vep. e cit. fq. 122.

51 Michele Marchianò, *Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia*, Foggia, 1908, fq. 28. Le të shihen edhe: R. Sokoli, vep. e cit. fq. 123; *Historia e letërsisë shqipe*, I, Tiranë, 1959, fq. 17-18.

procesi i prodhimit.⁵² Nga kjo arsye femna jonë fshatare nuk e ndien vehten të shtrëngueme, por shpreh lirisht në kangë dëshirat dhe aspiratat e veta të martohet me njeri punues si ajo. Këte dashuni të saj për punë jashta shtëpisë e dëshmojnë shumë kangë të saj që i thur e i këndon me andje e që ndëgjohen me kujdes dhe thuren edhe të tjera nga mbarë popullsia, pse si thekson Engelsi „Poppujt ku gratë duhet të punojnë shumë më tepër se sa u takon simbas botëkuptimeve tona, shpeshherë ushqejnë për gra shumë më tepër respekt të vërtetë se sa Europeanët tanë.”⁵³ Këte nderim të thellë femna jonë e meriton me gjithmend, e sidomos në jetën bashkëkohore kur ajo gjithnji e më tepër po i tregon me prova kualitetet e shkathtësisë së saj në punë, gjë e cila, si do të shohim, pasqyrohet në kangët tona popullore të sotme.

Ndërkaq, protagonistët e disa kangëve tona epike me tematikë të lidhuna me bujqësi, veprojnë nën ndikimin e kushteve ekonomike të vështira në të kaluemen, kur frytet e njerëzve punues shfrytëzoheshin nga sistemet feudale dhe kapitaliste. Prandej në folklorin tonë është pasqyrue rezistenca e shtresave të vorfëna kundër padrejtësisë shoqnore që u bëhej. Nji këso kange është ajo e *Halit Gashit* që paraqet katundarin tonë t'unshëm për tokë, i cili krahas me burimin e punës çmon dhe mbron nderin familjar, dinjitetin personal, pse, pajisë me koncept të naltë morali, vret Beqiragën në vend që për nji copë toke t'i dorzonte motrën Hajri „Coll si i ka dy syt e zi”.⁵⁴

Në relacione me bujqësinë na paraqiten, gjithashtu, kangë rreth të *bluejtunët të grunit në mulli*, të cilat shtjellojnë motivin e punës së njeriut në të siguruemit t'ushqimit për jetesë. Kjo kuptohet nga arsyeja se mullini ze vend të randësishëm në jetën e popullit punues, mbasi kunorëzon frytin e punës së bujkut i cili ndien dhe çfaq kënaqësinë kur dërgon drithë me blue, sidomos grunin.⁵⁵ Në ritet e darsmës, mullini shpreh traditat e lashta të popullit, rreth të cilit këndohen mjaft kangë.⁵⁶ Por, n'anën tjetër, mullini thuret mjaft, sidomos, në kangët e dashunisë. Ai është vend i përshtatshëm ku takohen protagonistët e rij të kangës në punë e sipër. Shumë kangë të tilla thuren përmes dialogjeve të tyne: vajzës që bie grun në mulli me blue dhe mullisit i cili, zakonisht, paraqitet djalë i ri, si ç'ndodh në kangën e përhapun mjaft „Ore mullixhi, o ti djál i ri...”

52 Krah. Injac Zamputi, *Pozita shoqnore e grues malësore shqiptare sipas kanunit*, Buletin i USHT, ser. Shk. Shoq. 2/1961, fq. 110.

53 Fridrih Engels, *Poreklo porodice, privatne svojine i države*, Beograd, 1960, fq. 55.

54 Krah. kangën *Halit Gashi*, në *Kangë popullore shqiptare të Kosovë-Metohis*, bleni i II, Prishtinë, 1952, fq. 181-182.

55 *Kanuni i Lekë Dukagjinit* i kushton posaçërisht mullinit nyjen gjashtëdhetenandë, në të cilën të drejtën e mullisit dhe të barrtorëvet e rregullon me §§ 331-340, prej nga shihet roli që luan mullini në marrëdhëniet shoqnore dhe në jetën e popullsisë.

56 Krah. *Visaret e Kombit*, Vëllimi III, Tiranë, 1937, fq. 238; Thimi Mitko, vep. e cit. fq. 33; Qemal Haxhihasani, *Kërkime dhe vëzhgime folklor*

Kangët e motmotit (kalendarike) ose pagane, në një anë na njohin me synimet dhe orvatjet e njeriut tonë punues në periudha shoqërore të ndryshme drejt përmirësimit të kushteve elementare natyrore, pra me sigurimin e vetë rezultateve të punës me bagëti dhe të korra të begatshme, dhe në anën tjetër, ato janë pasqyrë e punës së blegtorit dhe të bujkut gjatë të gjitha stinëve të motmotit. Prandaj, për hir të karakterit arkaik që kanë këto kangë pagane: rreth buzmit, kolendrat, llazoret, dordolecat, kangët e ditës së verës, të Shëngjergjit, rreth një majit pagan, kangët për diellin, për hanën etj., do t'i trajtojmë në një punim të veçantë, pse janë me interes për studimet tona folkloristike.

6. Të pasqyruemit e punës në ninulën tonë të vjetër dhe bashkëkohore

Megjithë funksionin e veçantë dhe karakterin individual që ka ninula, me të cilën nana ven fëmijën në gjumë, është interesante se edhe ajo ka lidhje indirekte me punën, e cila pasqyrohet në lëndën e saj poetike. Mbas një vështrimi përmbledhës që u bëmë ninulave tona të botueme deri më tash dhe të një numri relativisht të shënueshëm që kemi mbledhë në teren, sjellim gjykimin se numri më i madh i tyre u është kushtue fëmijëve (foshnjëve) mashkuj. Kjo vjen si rrjedhim i diferencimeve shoqërore në të kaluemen në relacione mashkull — femër dhe ven në pah qartë pozitën e nënshtrume të gruas në rregullimin shoqëror patriarkal.

Asht me randësi të pohohet se ninulave u paraprijnë ritet dhe kangët e tjera rituale rreth lindjes së fëmijës. Të dhanat e deritashme⁵⁷ si dhe kërkimet tona në teren tregojnë ekzistencën e ritit, dokeve dhe zakoneve rreth lindjes së fëmijës ndër Shqiptarë, si ndodh, madje, edhe ndër popuj të tjerë. Si në viset e Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi etj. të banueme nga popullsia shqiptare, ashtu edhe në rrethinat e Ferizajt, nga po sjellim numrin më të madh të shembujve, lindja e djalit pritet me gëzim shumë më të madh se për vajzën. Kur gratë e vizitojnë llahusën (lehonën) nëqoftëse lind djalë i thonë: „Kóft me jét t'gát e me vllazní — me báb me nân! Pej tí u shtëft ni maháll!...” urime këto që reflektohen në ninulat e nanës:

rike në rrethin e Përmetit, Buletin i USHT, ser. Shk. Shoq., 2/1959, fq. 140; Agron Fico, *Kërkime folklorike në krahinën e Zagorisë*, Buletin i USHT, ser. Shk. Shoq. 2/1961, fq. 142.

57 Le të krahasohen këto burime: G. Weigand, *Albanesische Grammatik im südgegische Dialekt*, Leipzig, 1913, fq. 154; *Historia e letërsisë shqipe I*, Tiranë, 1959, fq. 31-34; Stavro Th. Frashëri, *Folklor Shqiptar*, Durrës, 1936, fq. 21-27, 29-37; Vasil Xhaçka, *Lindja dhe martesë në Devoll*, Buletin i USHT, ser. Shk. Shoq. 1/1959, fq. 199-201; Qemal Haxhihasani, vep. e cit. fq. 133-134; Agron Fico, *Kërkime folklorike në Krahinën e Zagorisë*, vep. e cit. fq. 135-136; Shefqet Hoxha, *Lindja në Lumë*, Buletin i USHT, ser. Shk. Shoq. 2/1961, fq. 245-250; Gj. Komnino, vep. e cit. fq. 3-4; Vidosava Milosavljević, *Prilog proučavanju običaja oko novorodenčeta*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije IV-V, Priština, 1959-1960, fq. 315-322.

15



Nina nâna, n'djep me kâsht-e,
Ti m'u rritsh me vllazën gjâsht-e!

Nina nâna, n'djep me sân-e,
Ti m'u rritsh me bâb me nân-e!

Nina nâna, n'djep me tâll-e,
Ti m'u rritsh, u bâfsh mahâll-e!⁵⁸

Ka raste kur lindjen e djalit, sidomos kur pritet kaherë, vaj-
zat e gëzueme e kumtojnë me kangë nga çardaku tue i rá deficit:

16



Ani a po nîni oj mahâll-e, o,
Ani Hazir-aga e ka ni djâl-e, o!

Ani a po nîni o katun-e, o,
Ani t'Hazir-agës jân bâ shum-e, o! ⁵⁹

N'anën tjetër për lindjen e vajzës llahusës i thonë: „Mos u mërzit! Ku âsht çika vjen edhe djali. Shyqyr qi pshtove! Kóft me nafák!...” Kuptohet se nana, e shtyme nga instinkti i dashunisë amnore, i këndon me kënaqësi edhe vajzës, por edhe ajo dëshiron pjellen e ardhshme që të jetë djalë, prandej në mes të tjerash i këndon kërthisë :

Nina nâna, djepi plot-e,
Çik sivjet-o e djâl n'mot-e! ⁶⁰

58 E shënuem në rrethinat e Ferizajt, Kosovë.

59 Kështu ndodh në kat. Sazli, Ferizaj, ku e shënuem kët kangë.

60 Këndohet me melodinë e shembullit № 15.

Ky gëzim kaq i madh për lindjen e djalit, e për vajzën njëfarë qëndrimi papërfillës në kushtet shoqërore të një standardi t'ulët me mjete të prodhimit të dobëta në të kaluemen, janë të lidhura me interesat e shtimit të fuqisë puntore,⁶¹ pse ndërsa „Grueja shqyp-tare farë trashigimit s'ka as te prindja, as më plâng, as në shpí, — kanuja e xën gruen si një tepricë në shpí”⁶² mashkulli n'anën tjetër „M'u martue më kanún do' me thánë m'u bâ shpí, me i a shtue shpís një rob mâ teper, sá per krah të pûnve, sá per të shtu-em të fmíve.”⁶³ Prandej për hir të këtij shtimi të shtëpisë me „krah të punëve” dhe të sigurimit të vazhdimsisë së familjes, — farefisi dhe grueja, e cila synon me krye detyrën e vet sa mâ mirë, i përqëndrojnë dëshirat dhe synimet e tyre në lindjen e fëmijës mashkull. Shterpësia e grues nuk shikohet me sy të mirë, madje edhe urrehet, kurse grueja-nanë, e sidomos nëqoftëse është nana e mâ shumë djemve, gëzon autoritet dhe respekt të pakufishëm.⁶⁴ Prandej ajo në ninulën e vet shqipton me ndërgjegje vargje t'atilla dhe uron djalin, *T'i m'u rritsh me vllazen gjásh-e! Ti m'u rritsh-u bâfsh maháll-e!* etj. Nga këto arësye kuptojmë esencën e gjithë atyne urimeve që fëmijët në *kangët e motmotit* u drejtojnë zonjave të shtëpisë me rastin e kremteve popullore me tradita të lashta, si shi-het në këte kolendër toske:

... Dil moj, dalç e bardhë,
Gjer' mot me një djalë,
Dil moj, dalç e kuqe,
Gjer' mot me një nuse. 65

ose në një kudhanë geqe :

... Del e del e dalsh e bardhë!
Sot me barrë e mot me djalë!
A po del a po shkojmë? 66

N'anën tjetër, femna jonë fshatare në ditën e Shëngjergjit shpreh dëshirën që të bâhet nanë e djalit, madje, e *djalit trim*⁶⁷ t'aftë në punë dhe në jetë e sidomos trashëgimtar i denjë i familjes në mënyrë që të kënaq dëshirat dhe pritjet e farefisit, me çka i rritet vleftha në syt e tyre dhe të botës, si na dëshmon kjo ninulë :

61 Kjo vërtetësi hetohet edhe në shembujt e tjerë të ninulave që kemi shënue, të cilët do të parashtrohen në një punim të veçantë rreth poezisë dhe muzikës së ninulave tona popullore.

62 Kanuni i Lekë Dukagjinit, vep. e cit. Nye i njizetët, fq. 14.

63 Po aty, § 28.

64 Krah. I. Zamputi, vep. e cit. fq. 105.

65 Thimi Mitko, vep. e cit. fq. 40.

66 P. Vinçenc Prennushi, *Kangë popullore gegnishte*, Sarajevo, 1911, fq. 153.

67 Krah. I. Zamputi, vep. e cit. fq. 114-115.

17



Erdh shinxherxhi, o na erdh i lumi-o,
 Nina nana çikën p'e përkuni-o!

O shinxherxh-o, o ti kofsh i bårdh-e o,
 Tash motmot-o, ani, m'xhetsh me djål-e o!

Xhith kush t'nift-o, o m'márrt-e lakmí-e, o,
 O ç'i m'ka lé djali, m'ka lé trimi-o!

O shinxherxh-o, o ti árdhsh me t'mira-o,
 Sod motmot i knofsha trimit: nín' nín-o!⁶⁸

Nën ndikimin e ndërgjegjies shoqnore regjionale, një nanë e tillë jo vetëm që dëshiron t'i lindë djalë por edhe ai të bâhet njeri shembullor në punë: çoban i shkathët, bujk i vyeshëm, zot shtëpie i mirë, kryeplak katundi etj. Asht interesante se në një ninulë të vjetër, me randësi etnopsikologjike, mësojmë dëshirën e nanës që i biri i saj t'i bâhet i urtë në mënyrë që të jetë i denjë me pleqnue gjaqet ndër pleqëni (pleqësi) ose ndër fise⁶⁹ si thuhet në te, dhe tue evitue hakmarrjen mizore, të bâhet i dobishëm për bashkësi :

18



Nina nana, po t'përkuni,
 Ti m'u bâfsh kryeplak katuni!

Kryeplak-o m'u marue,
 Xhith nër fise ti me shkue!

T'tâna xhaçet me-i pajtue,
 Krejt vllaznin me-i rahatue!

Krejt vllaznin me-i rahatue,
 Nermjeveti mîr me shkue!
 A nín', nín', nín', nín'!

68 Këte kangë e shënuem në ditën e Shëngjergjit në rrethinat e Ferizajt.

69 Në këtë ninulë, të cilën e shënuem në rrethinat e Ferizajt, fjala fise paraqitet si term që emnon pjesëmarrësit e pleqënive (pleqësive) të cilët, tue u mbështetë në normat kanunore të së drejtës tradicionale, pleqnojnë gjaqet dhe mosmarrëveshjet e tjera midis njerëzvet. Kështu, përveç kupti-

Me këte kjo nanë shpreh, në të vërtetë, ndjenjën njerëzore amnore ndaj ruejtjes së pjellës së njeriut, çka është e përbashkët për të gjitha nanat. Por nana jonë, mbasi sheh rrjedhimet e kobshme të gjakderdhjes, e vlerëson misionin e pleqnimit të konflikteve fatale si gjâ të shejtë, prandej i uron të birit të marri pjesë në të tilla pleqni pajtuese të mbeshtetuna në Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Ndërkaq, në ninulat bashkëkohore nana kërkon që i biri të ndjekë rregullisht shkollën dhe të bâhet intelektual shembullor, si shihet në këte ninulë të Preshevës:

19



Nin' Agimin, djalin t'em-e,
Du me t'çu çoban me dhen-e!

Jo çoban me dhen nuk due,
Ty don nana me t'shkollue!

Nin' Agimin n'djep me molla,
Ty t'çon nana neper shkolla!

Nina djalin n'djep me sumlla,
Ty t'rrit nana vetem n'kundra!

Ty t'rrit nana n'kundra t'randa,
Profesor-o ty t'ban nana!

Profesor-o ma i madhi,
E ki yllin mjedis balli!

Ylli nanes po vizllon-e,
Per ty nana gjith po kndon-e!
A nin', nin', aaá...

Këto ndërrime kualitative të ninulavet tona popullore janë fryte të Revolucionit Popullor dhe vijnë si shprehje të ndërrimevet shoqnore te ne, ku arsimimi i popullit ka marrë vrull në përpjestime të gjana. Nana në ballin e fëmijës së vet vegon yllin partizan. Kjo gjâ paraqet simbolikën e fatit të mbarë të fëmijës, i cili nuk është i destinuem mâ të jetë si përparandej vetëm çoban, por të bâhet punëtor intelektual, çka tregon, njëkohësisht, edhe ndjenjën e zgjue-me të femnës sonë ndaj progresit bashkëkohor. Në një ninulë tjetër të re nana në fëmijën e vet, djalin, sheh partizanin „trim si zâna” dhe i drejtohet me lutje, e nxit dhe pret prej tij që ta bâjë „anmikun gur’ e hî” për me jetue gjithmonë në liri.⁷⁰

mit të zakonshëm që ka fjala fise ajo përdoret si term i tillë edhe në përkufizime të tilla: Kët pûn e kan pleçnue dymdhet fise me Kanunin e Lekës: Xhakun e pajtuen (dymdhet) fiset; Kjo pûn ka hî me u pleçnue ner (dymdhet) fise etj. pra 12 pleq, 12 njerëz t'urtë dhe të drejtë. Si sinonime të termit fise (gjithnji në shumës) në këto rrethina përdoren edhe termet: pleç, krena, si bie fjala: Ket pûn s'un e zvjellójn ose s'un e marójn ose s'un e pajtójn ose s'un e krenójn ose s'un e drejtójn kërkuh veç (dymdhet) fiset, pleçt, krenat. Por, nuk thohet s'un e fismójn.

⁷⁰ Këte kangë, *Partizan t'mír ty t'ka nâna*, me dhetë distikë e botuem në rev. *Jeta e re*, Prishtinë, 3/1961, fq. 377-378.

N'anën tjetër, nana shpreh edhe ndaj vajzës tue përkundë në djep lirizmin që ndien në shpirt ndaj kësaj krijese së njomë. Ajo uron me vargje të kandshme bijën që të rritet shpejt, të bâhet vajzë e mirë, punëtore, përkah pamja të jetë tfillake (shtathedhun) me fytyrë kuqërreme — tipare këto që pasqyrojnë konceptet e popullit punues fshatar ndaj bukurisë së femnës, të cilën e kundron në prizmin e shëndetit, i cili është garanci për punë të suksesshme dhe pjellë të mbarë. Nga vetë vargjet e ninulavet kushtue vajzës, na pasqyrohet femna në pozitën e nënshtueme në kushtet e jetës patriarkale, të cilat ndikojnë që nana në kangë të kërkojë prej saj të bâhet „krah pune” fizike e ndërgjegjshme në shtëpinë e burrit, çka në mesin e shumë ninulavet të tjera na tregon edhe ky shembull:

20



Nina nâna djep me shîna,
T'i blén nâna trí maçina.

Trí maçina për me kúp-e,
N'dash mintâna, n'dash jelék-e.

Për me kúp ti mîr m'u msúe,
Shpijes tâne me-i nimúe!⁷¹

Mirëpo, nëqoftëse përparandej femna jonë kundrohej nga normat kanunore dhe botëkuptimet e shoqnisë patriarkale si e destinuar vetëm për „krah të punëve” fizike dhe sa me mëkambë brezin, tue e çveshë njëkohësisht nga e drejta e trashëgimit si te prindët ashtu edhe në shtëpinë e burrit, kjo sot në kushte shoqnore të reja është barazue juridikisht me mashkullin dhe përkrahet nga bashkësia shoqnore që të marri pjesë aktive në të gjitha lamitë e jetës shoqnore. Në këte fazë kur femna jonë, me anën e arsimimit dhe t'inkuadrimit në procesin e prodhimit modern, shkon gjithnji e më tepër kah realizimi i të drejtave që i takojnë, ndihet funksioni dhe roli i saj në jetën bashkëkohore. Prandej lindja e fëmijës femën sot shikohet më ndryshe, por jo plotësisht e çliruar nga paragjykimet e kohës së kaluar, që manifestohen aty-këtu, pse nuk kanë mundësi të mënjahen rranjësisht nga rrethi ynë për një kohë kaq të shkurtë. Nana jonë bashkëkohore e heton për s'afërmi këte ndryshim shoqnor në pozitën e femnës, prandej në ninulën që thur i parashikon dhe përcakton voglueshës së vet ardhmeninë fatlume, të cilën e sheh n'vegim si nxanëse të zellshme, madje edhe profesoreshë pse „Femnes mir i duhet dija”:

71 E shënuem në kat Hallaç të Lipjanit, Kosovë.



Po vjen xhumi tuj përvët-e,
A ka rá Drita me fjët-e?

Femnës nír i duhet dija,
Mos më nëjt mã mshél te shpija.

Hem ka rae, hem ásht çue,
I mur librat shkoj me msue.

Mso, moj bí, ti mso pa dá,
Nâna n'zemër xhith ty t'ká!

Shkoj me shoçe n'shkóll me msue,
Jetën mír me sigurue.

Ke me kry gimnazin krejt-e,
Ke me shkue n'fakultet-e!

N'fakultet-e, n'shkóll të madhe,
Profesore hin n'Normale!
A nín', nín' nín', niná...⁷²

Forma dhe landa muzikore-metrike e trashëgueme⁷³ me vargun tetërrokësh, përveç në № 17 që paraqitet dheterrokëshi, nuk e pengon nanën në të thurunit e vargjeve të reja me mbrendi krejtësisht aktuale. Përkundrazi ajo i shërben si mjet tradicional, i cili mundëson, lehtëson, ndihmon, cyt të sprovuemit e të shprehunit poetik të nanës ndaj fëmijës së vet. Forma muzikore nuk paraqet pengesë në zhvillimin e kësaj fare poezie, por përkundrazi ajo është themel në të cilën mbështetet kjo farë krijimtarie artistike e femnës sonë, e pse literatura jonë njih më pak landë të tillë folklorike në krahasim me kangët e tjera lirike, nuk paraqet vorfëninë e saj, por të metën e folkloristikës dhe etnomuzikologjisë sonë. Çdo nanë, nga vetë shtytjet amnore, ndien nevojën me i këndue fëmijës së vet, por ajo kangën e përdor edhe si mjet utilitar pse me te qetëson foshnjën të cilës i shpreh prezencën e vet që ajo e ndien të nevojëshme në mënyrë instinktive. Prandej çdonjena sosh është e detyrueme të dijë disa ninula, ose së pakti të përsërisi disa herë të njajtën, derisa mã në fund t'ia mbërrijë qëllimit dhe me kadençën: *A nín', nín', nín', niün!; A nín', nín', nín', aaá...; A nín', nín', nín', niná...* etj. t'ia dorzojë fëmijën gjumit, element muzikor ky me randësi që shpejtëson ose përmbyll procesin e kësaj pune të nanës.

Meloditë e ninulave që dhamë enden mbrenda kuintës së pastër dhe sekstës së madhe, kurse kemi edhe disa shembuj të tjerë që lëvizin mbrenda kuartës së pastër. Ninulat tona popullore me

⁷² E mblodhëm në rrethinat e Ferizajt.

⁷³ Edhe në muzikën e ninulave tona popullore bashkëkohore, tue i krahasue me prototipet e tyre të trevave folklorike gjegjëse, hetojmë elemente të reja, të cilat paraqiten në kuadrin e ligjshmenisë së ndërrimeve që pëson dialektikisht çdo farë krijimtarie muzikore popullore, rreth të cilave këtu nuk mund të ndalemi mã gjatë.

ambitus mâ të madh ose mâ të vogël se këto janë fare të rralla. Tingujt e tyre rrjedhin në një vijë melodike relativisht të qetë, pa bredhje ngazllyese ose me vrull rrëmbyes si ngjet zakonisht në valle që shtien njeriun me kërcye ose në kangët e dashunisë, të cilat rrëfejnë ndjenja të shqetsueme. Kjo dukuni e zakonshme arsyetohet me disa pohime dhe vrojtime shkencore, një ndër të cilat mund të konsiderohet zbulimi interesant i fiziologut italian Dr. M. L. Patrici-t. Ai mbërriti me vërtetue se *muzika e gjallë* (e shpejtë) shton (rritë) sasinë e gjakut në tru dhe shpejtëson ritmin e pulsit, kurse përkundër kësaj, *muzika serioze*, e matun përkah lëvizja e tingujve, pakson sasinë e gjakut në tru dhe ngadalëson të rrahurit e zemrës.⁷⁴ Simbas këtij pohimi, që do pasë parasysh, nuk duen harrue edhe melodia, dinamika, shpejtësia, si elemente muzikore të randësishme që ndikojnë në krijimin e atmosferës për gjumë, e jo vetëm ritmi si gjykohet ndonjiherë në mënyrë arbitrare. Ritmi i ninulave popullore shqiptare pajtohet në të shumtën e herëve me ritmin e trokëllimës (krismës) së djepit gjatë të përkundunit, prandej na paraqitet në pëpjestime simetrike: 2, 3, 4, 6... të katërta, të teta, të gjashtëmbëdheta... dhe në variantet e tyre simetrike (shembujt tonë: 2/4, 3/4, 3/8, 6/16). Por kemi ninula edhe me ritme josimetrike: 5, 7, 9... të katërta, të teta, të gjashtëmbëdheta... dhe me variantet e tyre josimetrike (shembulli ynë № 20 në 7/8). Sidomos janë interesante për vrojtime ato ninula tona në të cilat paraqitet poliritmia. Këto ninula me ritme josimetrike mund të këndohen mâ lehtë tue e mbajtë fëmijën para duersh ose tue e luhatë në hule, si praktikohet gjatë verës. Lidhun me këte punë, jemi të bindun se ky ritëm i tyre josimetrik sajohet nën ndikimin e vetë ritmeve josimetrike që jetojnë natyrshëm në gjiun e folklorit muzikor shqiptar.

Këto çashtje tonpsikologjike me interes për etnomuzikologjinë tonë të re, që këtu i cekëm, pa u ndalë detalisht në shqyrtimin e tyre, na zdrisin, sadopak, funksionin e kësaj krijimtari poetike e muzikore të femnës sonë, e cila e fisnikon njeriun që nga ditët e para në jetë.

7. Vlerësimi i punës në kangët e përvajshme dhe në vajet

Edhe kangët që shprehin dhimbjen dhe pikllimin për njeriun e humbun përgjithmonë, nga të cilat del në shesh lidhja e tyre me jetën e popullsisë në raporte me punën në bujqësi, blegtori dhe degë të tjera t'ekonomisë popullore, trondisin thellë ata që i këndojnë dhe që i ndëgjojnë. Selman Brahimi, viktimë në hakmarrjen mizore, para se me e tretë dheu i zi, i drejtohet nanës me lutje që t'i mbarojë një vorr të gjanë me dy penxhere që të mund t'i sodisë lulet në pranverë, dushkun kah mugullon, qingjat tue lodrue, e kur të

⁷⁴ Nga ligjërata *Muzika në medicinë*, mbajtë nga Dr. Ilija Marinković, më 30 mars 1961 n'Institutin Muzikologjik t'Akademisë Serbe të Shkencave dhe t'Artëve në Beograd.

vijë koha e punës t'ia qesë në rrugë kosën, shatin, drapnin. Në kangë sidomos me lutjet e fundit rritet gradacioni i etjes të së shuemit ndaj jetës:

Ani kur t'vjen vakti,
Ani për me korr-e,
I: Ani drapnin tëm, moj nân,
Virmani në moll-e!: I

Ani gjith dynjaja,
Ani le t'bajn seri,
I: Ani qysh do t'kórr, moj nân,
Oh, drapni pa njëri?!: I 75

Strofa e fundit si katarzë e vërtetë ravizon poetikisht të vërtetën se mjeti i punës ka vleftën e vet vetëm në duert e njeriut të gjallë, me vdekjen e të cilit, aq më tepër kur ajo bâhet përdhuni, humb përgjithmonë një krah pune, mbështetëse kryesore e vazhdimsisë dhe ekzistencës familjare. Kjo kangë dhe të tjerat si këto dënojnë dhe mallkojnë emotivisht sjelljet e pamira të njerëzve të pandehun, prandej edhe i orientojnë kah marrëdhëniet e mira midis tyre. Në këte mënyrë, tue mënjauet të keqen kangët e tilla ndikojnë në shitimin e fuqisë puntorë; të cilën e njehin si gjanë më të çmueshme.

Se çfarë bukure jetike paraqet puna e njeriut dhe si vlerësohet ajo në poezinë popullore shqiptare na tregojnë nandë strofat e kësaj kange të ndieshme:

22

♩ = 132



Lul e kuqe, lul boj pembe,
Oj ti cik-o shoqja jeme,
Oj ver, oj ver oj ver-o!

Jemi shoqe përgjithmon-e,
Veç exheli kur na dan-e,
Oj ver, oj ver, oj ver-o!

O exhel, exhel i shkret-e,
Gji s'na laje dy qin vjet-e,
Oj ver, oj ver, oj ver-o!

Dy qin vjet e ni motmot-e,
Ngata ngatas me ni vorr-e,
Oj ver, oj ver, oj ver-o!

Ngata ngatas me ni penxhere,
T'i shofim lulat ne pranver-e,
Oj ver, oj ver, oj ver-o!

T'i shofim lulat tuj lulue,
Ta shofim baben tuj lavrue,
Oj ver, oj ver, oj ver-o!

*Ta shofim nanen tuj gatue,
Ta shofim motren drék tuj çue,
Oj vér, oj vér, oj vér-o!*

*Ta shofim vllaun n'shkóll tuj shkue,
„Nalu vllá e t'shkojna bashk-e!”
Oj vér, oj vér, oj vér-o!*

*„Nalu vllá e t'shkojna bashk-e!
S'po m'len burgu me dál jasht-e,
Oj vér, oj vér, oj vér-o! 76*

Përveç punës fizike, madje ate të mashkullit (babës) dhe të femnës (nanës e motrës) në dy strofat e fundit na paraqitet edhe puna intelektuale, element i ri i mbërthyem në kangën e vjetër nën ndikimin e jetës bashkëkohore, çka sidomos e thekson dëshirën e femnës sonë të zgjueme për shkollë. Këte gjakim të saj e ndeshim edhe në kangët e tjera të ditëve tona, si do të shohim më poshtë.

Punën si motiv e hasim edhe në shumicën e kangëve tona të vajtimit, si ngjet edhe me ato të popujve të tjerë të të gjitha kohëve. Si pjesë të kultit të të vdekunit, vajet, në mes tjerash, zbulojnë dhe intelektuale, element i ri i mbërthyem në kangën e vjetër nën ndikimin e prandej janë me interes për studimet folkloristike. Gjatë rrëfimit të pikllimit për humbjen e njeriut të dashtun, çfaqet njikohësisht dëshprimi për bjerrjen që pësoi familja për fuqinë puntore:

*... E mjeri un dera e gjënë e buka e dhanë!
E mjeri un puntori i punës!
E mjeri un shtegtari i rrugës!
A kshtû mbahet nâna, o vllá!
A kshtû mbahet konaku, o vllá!
A kshtu priten miqt, o vllá!
A kshtû priten dashamirët, o vllá! etj. 77*

Kur kangët e vajtimit u drejtohen të shuemve të rij, e sidomos ndonji djali të dëshirt, përmallë, me vdekjen e të cilit fiket familja (në kangë thuhet shpija, fisi), atbotë poetika popullore arrin kulmin e pikllimit dhe na pasqyron më dukshëm elementet e notës ekonomike-shoqnore në relacion me punën dhe vazhdimsinë familjare.

8. Puna si motiv në kangë të ndryshme

Nji seri kangësh të tjera në gjiun e folklorit shqiptar thuren rreth punëve të ndryshme nga shumë lami të veprimtarisë së njeriut, së pakti punët e tilla reflektohen si motive në poezinë tonë popullore. Fytyrat e zanatlive të ndryshëm: terzive, dugajxhive, kazazëve, kujunxhive, nallbanëve, pajtonxhive (karrocierëve), qi-

76 Kangën e shënuem nga nji grup vajzash në kat. Blaq, Opojë, në qershor të vjetit 1957.

77 Folklorë III, Kangë e vajtime, Shkodër, 1940, fq. 118.

raxhive, pemëshitësve, sharaxhive etj. vijnë e na gërshetohen në brumin poetik të kangëve tona populllore. Pse disa nga këto zanate ose janë zhdukë ose janë në humbje e sipër, këto kangë mbajnë më vehte të dhana me interes për studimet etnologjike, kurse në lidhje me trajtesën tonë paraqesin një dëshmi më tepër të pasqyrimin të qartë të punës në krijimtarinë poetike-muzikore të popullit tonë. Shumica e këtyne kangëve janë të lidhuna me motivin e dashunisë dhe zhvillohen përmes tij, por kemi edhe t'atilla me notë thjesht sociale. Në disa kangë reflektohet puna e Dibranëvet si muratorë të përmendun, që në të kaluemen ndërtojshin në viset e Kosovës kulla, xhami, shtëpi:

*Kto dritore t'lyme me bój-e,
Dibrani, mor', po i maron.
Of amon!
Or' Dibran, more Dibran-e,
T'lumshin durt m'ir po i maron! etj.⁷⁸*

Populli i do dhe i çmon kangëtarët, prandej rreth tyre thuren kangë, si bie fjala „Kanga e Velis”, „Kanga e Sali Syles”, të cilët ranë viktimë gjatë të kënduemit. Ndërkaq, në personazhin e disa kangëve paraqiten kangëtarët së bashku me instrumentet e tyre: me çitelinë, sharkinë, karadyzenin, fyellin, tupanin... dhe defatorët. Asht interesante se në kangët tona e hasim edhe figurën e piktorit tue punue në kishë pranë vashës: „Vasha na qëndiste, /Trimi zografiste”...⁷⁹

Sidomos kangët e dashunisë paraqesin brumë të përshtatshëm për shtjellimin e punës si motiv. Kangëtari anonim nga gjiu i popullit, në këte rast i dashunuem, për protagoniste të kangës zgjedh gruen e shëndoshë, t'aftë, e cila mund të japë trashëgimtarë të shëndoshë dhe të kryejë punë fizike përkatëse. Prandej atij ia kanda me pá dhe me gjetë të dashunën e zemrës jo vetëm si bareshë, mjelcore, korrëse, shatore, si pamë më nalt, por edhe tue punue në vek, tue gatue, tue lá tesha, etj. kurse qytetari do që dashnorja e tij të qëndisë në gjergjef, të bájë ojme, të qepë rrcbe në maqinë etj. Në *Kangën e Mihanës*⁸⁰ ose n'ate të *Mines*⁸¹ hetojmë gjurmët e motivit të lashtë që e hasim shpesh në mitologji, sidomos n'ate antike:

78 Fragment i një kange rreth Dibranëvet, të cilën e shënuem nga Halil Haliti, kat. *Sherret, Ferizaj*.

79 Gj. Komnino, vep, e cit. fq. 269.

80 *Kanga e Mihanës* mbasi shpreh motiv emocional që pëlqen populli pamasë është mjaft e përhapun dhe ka disa variante. Le të shihen disa nga këto: Lorenc Antoni, *Folklori muzikuer shqiptar*, bleni i parë, Prishtinë, 1956, fq. 54 dhe në blenin e dytë, vep. e cit. fq. 91-92, Qamili i Vogël, *Me sharkin e Ymer Rizës*, Prishtinë, bot. i parë 1959, bot. i dytë 1961, fq. 17-18; Шедфет Плана, Рад као мотив у арбанашкој народној песми, Рад VIII КОНГРЕСА САВЕЗА ФОЛКЛОРИСТА ЈУГОСЛАВИЈЕ, БЕОГРАД, 1961, fq. 429-430.

81 Le të shihet në përmbledhjen *Këngë populllore shqiptare*, Tiranë, 1959, fq. 36-37.

shndërrimin e njeriut në shpend, gur, dru (pemë)... Në këto dy kangë tona — dy motërzime të bukura me formë muzikore të zhvillueme që ngjiten deri n'oktavë të pastër, me mjaft interjekcione, të cilat ravizojnë erotikën, mashkulli shpreh dëshirën të shndërrohet në shpend, zakonisht në bylbyl, çka ndodh edhe në kangët tona të tjera, vetëm e vetëm me pá dashnoren tue punue (tue gatue, tue qëndisë, tue i ruejtë dhent, pranë vekut) dhe në rrasën e gurit të kronit në mënyrë që mbi trupin e vet t'i ndiejë duert e femnës që e dashunon.

N'anën tjetër, femna jonë fshatare cyt në kangë mjetet e saj të punës për të shpejtësue ritmin e punës, vetëm e vetëm të krenohet me mjeshturinë e vet kur t'ia falë mestet e bukura jaranit:

23



Mori Nifo, mori pika-pika,
 Merre furkën, Nifo, dil nër çika!
 Merre furkën, Nifo, dil ma shpejt-e!
 Se jarani, besa, është kah t'pret-e!
 „Tjerru furko, kurr-o mos u tjerrsh-e!
 Dridhu boshto, kurr-o mos u dridhsh-e!
 Pshtillu lāmsho, kurr-o mos u pshtjellsh-e!
 E kām lānun jaranin kah m'pret-e!
 Ni pār meste ja kām marū vet-e!”
 Për bīr t'gardhit Nifa po m'ja jep-e,
 „Merri, djalo, ti i bājsh me shnet-e!
 Se kso pune, djalo, punoj vet-e!”⁸²

Këto përkushtime dhe dhurata midis protagonistëve të kangëve tona të dashunisë, të thuruna përmes punës si motiv, pasqyrojnë një erotikë popullore të pastër, pa korrupsion që mund të haset herë-herë në kagët e qytetit të mbërthyeme me elemente të konceptit moral në raportet e dashunisë feudale ose borgjeze.

Kangët e nizamëve dhe të gyrbetit pasqyrojnë gjendjen ekonomike të mjerë që ka përjetue popullsia jonë në të kaluemen. Në një anë shohim vuetjet e protagonistëve nga puna fizike e randë sa për një kafshatë të bukës, kurse n'anën tjetër, si pasojë të paksimit të fuqisë puntore mbretnon skamja deri në shkatërrimin e familjevet. Nga kjo kangë kosovare mësojmë jetën dhe punën e vështirë të nizamëve tonë n'ushtrinë e perandorisë turke:

82 Kangën e shënuem nga Salih e Feriz Krasniqi, më shtator 1961.



Kah po vîn kta nizâm t'ri,
Po na vîn prej Rumelîs-e,
Kaj mori nân-e kaj!

Tuj ra shî e tuj ra bôr,
Ç'm'u ka ngri martina n'dôr-e,
Kaj mori zeza nân!

Tesha t'zeza vësh me rrypa,
Peksimetri bûk me kryma,
Kaj mori nân-e kaj!

Pa dâl dilli po na çojn
Me samâr, po na ngarkójn-e,
Kaj mori zeza nân!

Gúr e dhé po na ngarkójn,
Zabitllárt po na çortójn-e,
Kaj mori nân-e kaj! 83

Në kangët e gyrbetit që kemi mbledhë n'Opojë, në Dibër, në Tetovë, në rrethinën e Strugës, Ohrit, Manastirit, Kërçovës, Prespës — vise këto që kanë dhanë mâ së shumti gyrbeçarë, janë në qendër të vemendjes pezmi i bashkëshortes, nanës, fëmijve, farefisit, por sidomos të së dashunës së gyrbeçarit, i cili klith nga vujtjet fizike dhe shpirtnore:

Eo, mjeri unë i mjeri,
Si të shkojm', nënë, këtë jetë,
Aaa, ajde, bre-o!

Shumë me hidhërime,
O shumë me sikletë,
Aaa, ajde, bre -o!

Se ç'u ngritmë djema, bobo,
Shkuam në kurbetë,
Aaa, ajde, bre -o! etj. 84

Gyrbeçarët shkojnë fëmijë e këthehen pleq — shkojnë të shëndoshë e këthehen invalidë. Megjithë punën e bame në kondita të vështira, nga shfrytzimi deri në palcë dhe tue i pague „borxhet”, — gyrbeçarët nuk kanë me se me i pague as shpenzimet e rrugës për t'u këthye në vendlindje prandej klithin nga pezmi:

83 Kangën e shënuem më korrik të vjetit 1948 nga një grup puntorësh në Elez-han, komuna e Kaçanikut, Kosovë. Motërzimet e kësaj mund të shihen në blenin e parë të përmbledhjes së cit. të L. Antonit, fq. 94—95; te Gj. Komnino, vep. e cit. fq. 284—285.

84 Fragment i një kange nga Prespa, të cilën e botuem në rev. *Jeta e re*, Prishtinë, 2/1962, fq. 277—278.

*Mor', navllënë ej s'munt ta zëmë,
Oj kemi borxhe për të dhënë!
Oi, oi, oi, aman, oi, oi, oi!*

*Oj kemi borxhe për të dhënë,
Oj se „miqtë” mirë na bënë!
Oi, oi, oi, aman, oi, oi, oi!*

*Oj mjeri un' që u bësh' i lik,
Oj as për veti, oj, as për mik!
Oi, oi, oi, aman, oi, oi, oi!* 85

Këtu kemi të bâjmë me një poetikë popullore jashtzakonisht të prekshme, por jo rezignante — të dhimbëshme, por me qëndrim stoik në përballimin e së keqes.

Në kohën kur bashkësia jonë i kushton vemendjen sigurimit të kushteve për punë në çdo pëllambë të vendit tonë, kangët e tilla me motive të gyrbetit ndër ne mbesin si dëshmi të jetesës me plot travajë në të kaluemen dhe paraqesin landë folklorike me interes për studime shkencore.

9. Puna në kangët me tematikë nga ndërtimi socialist

Sadoqë në këte punim jemi ballafaque me disa kangë tona popullore, të cilat shtjellojnë punën si motiv në raporte me kushtet e reja ekonomike-shoqnore gjatë periudhës së ndërtimit socialist në vendin tonë, prapseprap mbetet me shqyrtue një numër mjaft të madh kangësh të tilla, të mbledhuna në teren gjatë vjetëvet të fundit. Mbasi një landë e tillë folklorike e vëllimshme kërkon vend më të madh se sa mund t'i kushtojmë në trajtesën tonë, me këte rast do të ndalemi rreth disa kangëvet, të cilat pasqyrojnë dukshëm punën dhe orvatjet e rinisë, popullit, në të krijuemit e një jete më të lumtun, e sidomos e shohim t'arsyeshme t'i hedhim një vështrim kangëve që flasin mbi emancipimin e femnës shqiptare.

Gjatë akcioneve vullnetare të punës së mbarë popullit për të rindërtue dhe ndërtue vendin e shkatrruem nga lufta dhe të mbrapambetun nën ndikimin e shfrytzimit feudal dhe borgjez, kangës i takon funksioni shoqnor i randësishëm pse ajo thërret në punë dhe shpreh rolin vendimtar që kjo ushtron në formimin e njeriut të ri:

*Hajd' t'punojmë,
Djersët le t'kullojnë,
Se ndërtojmë,
Njeriun e ri!* 86

Kanga ravizon poetikisht ndërgjegjën e zgjueme të rinisë, e cila me punë të vazhdueshme i sjell vendit pamjen e re:

85 Po aty, fq. 278—279.

86 Refreni i kangës *O të rij dhe të reja, i madh është numri jon', të cilën e shënuem në Prishtinë, më 1947.*

*Qe na jem' rinija,
Në pun' jem' tuj shkue,
Na thërret vet'dija,
Vendin me ndërtue.*

*Tralala, tralala,
Me lopata në krah,
Na në pun' po shkojm',
Vendin ta ndërtojm'!* 87

Kangët këndojnë jetën e rinisë lidhë me akcionet e tyne të punës rreth ndërtimit të hekurudhave, autostradave, fabrikave, qyteteve, shkollave, spitaleve dhe objekteve të tjera. Rinia Popullore zotohet me kangë se do ta kryejë mbrenda afatit të caktuem hekurudhën që ka marrë mbi vehte:

*Shamac — Sarajevë,
Vend punimi jonë,
Mbrenda kësaj vere,
Rrugën ta ndërtojmë!*

Tralala, tralala etj. 88

Gjatë akcionit të përbashkët të rijt ndiejnë organikisht nevojën me i këndue punës së tyne kolektive, madje ndonjiherë edhe me vargje jetëshkurtë, por jashtzakonisht funksionale në çastin përkatës — që të gjithat na flasin mbi vetëmohimin dhe vendosmeninë e tyne me krijue jetën e re. Në lidhje me trajtesën tonë është me randësi vërtetësia se kangët e tilla me funksion shoqnor të pazavendsueshëm lindin dhe jetojnë përmes punës kolektive të rinisë. Madje, si në rastet e tjera ashtu edhe në mezin e këtyne kangëve hetojmë ligjshmeninë e aktualizimit të tyne me përmbajtje të re. Vërejmë se melodia dhe forma muzikore-metrike e një kange shërben si model për një tjetër, si ndodh në rastin konkret me kangën „Shamac — Sarajevë” e cila është thurë tue u mbështetë në melodinë dhe në strukturën metrike e formale të kangës „Qe na jem' rinija”.

Që të gjitha këto kangë vlerësojnë poetikisht pjesëmarrjen aktive në procesin e ndërtimit socialist si çashtje krenarie dhe nderi të brezit tonë të ri dhe të mbarë popullit.

Sot kur ndërtimi socialist hap fusha të gjana pune, të cilat përfshiejnë gjithnji e më tepër njerëz punues, kangëtari popullor, edhe vetë si punëtor i ndien për s'afërmi dhe i vëzhgon me interes këto ndryshime shoqnore, të cilat i shpreh poetikisht, madje i ravizon

87 Fragment i kangës që shënuem gjatë akcioneve të rinisë në punë vullnetare, në Prishtinë më 1946.

88 Fragment i kangës që shënuem në Ferizaj më 1948.

edhe hiperbolikisht, nën ndikimin e ndërgjegjës dhe t'aspekteve ideologjike shoqnore, vargje këto që tingllojnë si antiteza në krahasim me papunësinë në të kaluemen historike:

*... Punon pop'lli bitevi,
Krejt nër rroga kena hí,
Si me pleç e si me t'rí,
Si me burra e me graní... ⁸⁹*

Nën ndikimin e kësaj pune pasqyrohet në shumë kangë standardi jetësor më i naltë të cilin e gëzon popullsia dikur fare e vorfën.

Disa kangë me interes për vrojtimet tona i kushtohen shëndetit popullor. Nëqoftëse në kangët e gyrbetit, n'ato të përvajshme dhe në vajet tona protagonistët e sëmuni, zakonisht nga tuberkulozi, nuk gjejnë shpëtim nga „heqimët” që u drejtohen me lutje, por kot, vdesin të rij, pa e pasë gëzue jetën, pa i pasë përdorë aftësitë e veta në përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjes, — në kangët bashkëkohore, nën kujdesin e bashkësisë socialiste, të sëmuni gjejnë shpëtimin dhe këthehen në mezin e punuesve. Nji nanë më se e lumtun që mjekët ia shpëtuen vajzën nga vdekja e sigurtë, klith prej gëzimit dhe rrëfen porosinë e ndjenjave të saja amnore në vend se të thurte ndonji vaj:

*... Ngoni vllazën, motra t'mija,
Sa munohet për t'rí shoqnia!
Për këtë punë na ka árdhë liria,
Mos me na shkú pòsht rinija!... ⁹⁰*

Sidomos e dashtun, njerëzore dhe fisnike na paraqitet figura e mjekut, infermierit, motrës së spitalit — që të gjithë të vetëmohueshëm dhe të kujdesshëm, të cilët kundërshtëpërblehen me vargje plot mirënjohje dhe evari të posaçme. Tri kangë të tilla i kushtohen Dr. Ali Sokolit, nga nji Dr. Daut Mustafas e Dr. Xheladin Dedas; përmendet infermieri Nexhat Duli e shumë mjekë dhe puntorë medicinalë të paemnuem. Mbi të gjitha na tërheq vemendjen *Kanga e doktor Ali Sokolit*, e thurun nga të sëmuni e Dispanserit të Antituberkulozit, në Gjakovë, ku ai ka shërbye si ftiziolog, por ne e shënuem edhe në Podujevë si më të zhvillueme, çka tregon përhapjen e saj të gjanë:

⁸⁹ Fragment i nji kange që shënuem nga Zef Sokoli, punëtor dhe kangëtar 36 vjeçar, nga kat. Rakoc, Gjakovë, më dhëtor 1959.

⁹⁰ Fragment i nji kange që shënuem nga Sofë Tahirsylaj, kat. Isniq, Deçan, më mars 1959.

25



Dispanzeri pika-pika,
Na ka mledh-o gra e çika,
Na këqyr doktori sa t'jët dita,
Edhe natën na vjen n'vizita.
Ky doktor, doktor Alija,
Ç'po jep barna, inekcija;
Mos na bafshin ato dobi,
Frëm na jep aj brî për brî.
Pa pritës na këqyr përdit-e,
Aspak s'na len m'u mërzit-e:
„Mos mërziti motra t'mija,
Sod tre muj ieni te shpija!

Mas tre mujve kam m'u lshue,
T'shnosha n'shpi keni me shkue!”
Si baba fmis aj bût na flet,
Pak si t'smuhmi — na vjen shpejt.
Si nân me pás — na rrin përshejt,
Me ksi doktori s'asht zahmet.
Hiç për neve mos kini dert,
Bâni darsëm, bâni z'jafet!
Ne na shnósh doktor Alija,
Si e ma mîr na kthen te shpija.
I mjeri aj kush lingon n'shpi,
I shkon pösht krejt ajo rini!⁹¹

Asht me interes për vrojtime psikoanalitike mënyra se si e shohin dhe si e përshkruejnë kangëtalet e sëmuna procesin e punës së mjekut gjatë mjekimit të tyre, e sidomos me anën e dialogut me mjekun, që në të vërtetë ato çfaqin besimin ndaj shërimit të suksesshëm, përkundër pesimizmit që kishte me tingllue në një kangë të tillë me protagonistin e sëmune në një rast tjetër.⁹²

Kangët bashkëkohore të femnës shqiptare në relacione me punën pasqyrojnë qartë ndryshimet në pozitën e saj në familje dhe në shoqni. Çlirimi i saj nga çarshafi, ferexhja, xharri, terliku, havlia, — hapi i parë ky revolucionar drejt emancipimit të femnës sonë, u bâ shpejt motiv i disa kangëvet në të cilat mësojmë kënaqsinë e pakufijshme të saj që hoq nga vehtja një barrë të robnisë:

Ori grá, a keni nie,
Na ka dál ni lixh i rí-e,
Lixh i rí, oh, na ka dál-e,
Për me hjekun kët havále;
Kët havále për me hjék-e,
Çika me zgédh burrin vet-e.
Kjo ferexhja kóft mallkue,
E ma fort aj ci e ka prue!
Kúrr ner né s'á kân adet-e,

91 Këndoi Adile Muçolli, kat. Bajçinë, Podujevë, më prill 1959. Varianten e kësaj kange e shënuem nga Sofe Tahirsylaj, kat. Isniq Deçan, më dhjetor 1959.

92 Në mezin e kangëve të përvajshme, zakonisht me motiv nga gyrbe-ti, në të cilat „heqimi” nuk u gjen derman të sëmuneve nga tuberkulozi, janë më të njohura kangët që tingllojnë si motërzime: N'bash t'zamanit t'djelmë-nisë (Gj. Komnino, vep. e cit. fq. 261—262); Prej zemanit të djelmnis e Bash Zemanit të lezetit (Q. i Vogël, Me sharkin e Ymer Rizës, vep. e cit. fq. 11, 30—31) etj.

*Me mshël gruen n'shpì përrjët-e,
Tash p'e hjekim ket sën t'zì,
T'lumet na për këtë liri,
Do të rrnojm në barazi;
Si në pùn ashtu në shpì!* 93

Dëshira e femnës shqiptare me jetue në barazi, me marrë pjesë aktive në punë publike, si dhe mjaft materiale të tjera folklorike dhe të dhana historike e etnologjike, na bindin se femna jonë ka synue qysh moti një pozitë më të mirë, më të drejtë dhe më të randësishme si në familje ashtu edhe në shoqni, por mjerisht kurdoherë pengohej nga rrethi patriarkal dhe fetar që e kundërshtonte emancipimin e grues. Mirëpo, aspiratat e saj u përkrahën, u zhvilluen me ndërrimin e raporteve shoqnore ndër ne si fryte të ngadhnjimit të Revolucionit Popullor. Këto raporte shoqnore ndikuen që të ndryshohen mjaft marrëdhëniet mashkull-femën edhe mbrenda familjes. Për femnën në përgjithësi, e sidomos për këtë shqiptare, agoi ditë e re; për te u hapën shtigje të punës, në të cilat i sprovoi forcat dhe kudo tregoi prirje dhe aftësi. Në kangët e saj të cilat na dëshmojnë për një femnë të zgjueme dhe t'etshme për dije dhe punë, shprehen lëvizjet e saja shpirtnore të thella; mësojmë lumtuninë dhe gëzimin e saj, por edhe krenarinë që si nxanëse e denjë thith dije dhe formohet në kushte të përshtatshme:

*Gogël-gogël si kulumri,
Thón jam e vogël kurgjâ s'dí?!
Po un i kam ment e holla,
I marr librat, shkoj te shkolla.
Atje i gjâj shoqet e mija,
Çoni gishtat: rrnoft liri!
Rrnoft liri qì na ka árdh,
Na ka prue dit të bárdh!
Dit të bardha me shumë gzime,
Gjith u knaqëm n'shkóll me msime!* 94

Në kangët e tjera femna jonë i këndon mësueses, profesore-shës, mjekes... figura këto të përparueme të cilat i do, i çmon dhe i vlerëson is ideal të saj, prandej synon të mbërrijë edhe ajo vetë një pozitë të tillë në shoqni, të cilën e lakmon me gjithë shpirt.

Si bashkëshort të saj femna jonë katundare nuk zgjedh më vetëm çobanin ose bujkun e mirë si përpara, por ajo tash i këndon njeriut me vlerë shoqnore relativisht më të madhe — shpreh dashuninë ndaj punëtorit, intelektualit të zellshëm në punë. Ajo vehten e sheh si punëtores ose intelektuale në një ambient të kulturuem dhe t'industrializuem, në të cilin do të punojë dhe do të jetojë së bashku me të dashunin e vet, që si të rij të krijojnë jetën dhe familjen simbas botëkuptimeve bashkëkohore. Pra femna jonë çfaq një indivi-

93 E shënuem nga Zef Sokoli, më 1959.

94 Kënduen një grup vajzash nga kat. Shorban në rreth të Prishtinës, më 1959. Simotrat e kësaj kange që shënuem nga nxanëset e Drenicës, rrethit të Deçanit, Junikut, Gjakovës, Gjurakovcit, Podujevës, Lipjanit, Ferizajt tregojnë përhapjen e gjanë të këtij motivi që mbështetet në etnopsikologjinë e voglusheve shqiptare.

dulalitet ndaj krijimit të jetesës së re, e cila mbështetet në një standard jetësor më të lartë, ku mjetet e prodhimit duhet t'i shfrytzojnë vetë.

Mirëpo, kur synimet e tilla të femnës sonë hasin në pengesa nga paragjykimet patriarkale të përforcueme me ndikimin fetar, atbotë femna jonë me ndërgegje të zgjueme, çfaq në kangë mllëfin e grumbulluem në shpirtin e saj kundër një përbuzjeje të padrejtë nga „prindët zemër-guri” ose nga rrethi i mbrapambetun. Në poezinë tonë popullore të sotme gjejmë një pasqyrë t'ashpërsimit të luftës midis dy gjeneratave — në mes të vjetërvet që mundohen me ndalë rrotën e përparimit dialektik, dhe t'atye që i takojnë këtij progresi përparues të sodit. Prandej femna jonë e ngrit zanin në kangë dhe kundërshton martesën pa pëlqimin e saj, si shihet edhe nga vetë titujt e diçka kangëve të tilla: *Ku m'dha baba s'du me shkue; Nuk është, nân, qaj búrr për mue; Me ni djál jam besatue; Sod nuk është më koha e pâr, N'socjalizëm tash kemi mrrí etj.*⁹⁵ Por, n'anën tjetër, ajo edhe bekon, uron, përshëndet prindët kur synimet e saj i mirëkuptojnë dhe aprovojnë.⁹⁶

Ky material folklorik i krijuem vetë prej femnës sonë, na pasqyron pozitën e saj në jetën dhe shoqërinë bashkëkohore. Kjo nuk është më as nuk mund të jetë femna jonë e dikurshme që u nënshtrohej normave kanunore simbas së cilave s'kishte tagër „me zgjedhë fatin e vet; do të shkojë për atë, për të cilin t'a fejojnë.”⁹⁷ Femna jonë sot gjendet në pozitë shumë më të përshtatshme e cila i mundëson t'ushtruemit e aftësive dhe prirjeve të saj meqë i jepet mundësia t'i shfrytzojë vetë mjetet e prodhimit në kushtet e marrëdhënieve socialiste, sidomos kur për të kujdeset veçanërisht bashkësisia jonë.

Në mesin e shumë kangëve që disponojmë le të ndalemi vetëm rreth dy shembujve, të cilët na pasqyrojnë ndryshimet thelbore në personalitetin dhe pozitën e femnës sonë të këndueme në kangën e vjetër dhe në këte bashkëkohore. Përparandej vajza jonë tue mos pasë tagër me zgjedhë vetë bashkëshortin,⁹⁸ gjâ e cila u takonte ekskluzivisht vetëm t'jatisit ose mashkujve të farefisit,⁹⁹ ajo e grishte

95 Këto kangë do t'i kumtojmë me një rast të veçantë, mbasi kërkojnë vend më të gjanë se sa kemi në këte punim.

96 Po ashtu.

97 *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, vep. e cit. § 31.

98 Po aty, § 31. Megjithatë me § 36 të këtij Kanuni grueja e vejë ka tagër me folë vetë për kah martesë, nga se, ndoshta, mirret parasysh përvoja e saj që ka fitue në jetë.

99 këte gjâ, tue pasë parasysh veprën e Engelsit *Origjina e familjes, pronës private dhe e shtetit*, e kundrojmë si dukuni shoqërore normale, nëpër të cilën kanë kalue të gjithë popujt, por ndër Shqiptarë e drejta e prindëvet mbi të martuemit e fëmijve është shumë më gjatë, madje edhe deri në ditët tona. Engelsi pohon: „Para Mesjetës nuk mund të flitet mbi ndonji dashuni seksuale në baza individuale... Gjatë krejt Shekullit të Vjetër prindët kanë bërë martesat midis të rijvet dhe këta janë pajtue me këte pa kundërshtue. Një dozë dashunie që një Shekulli i Vjetër nuk është ndonji simpati subjektive, por detyrë objektive, nuk është shkak, por korelacion i martesës”. — F. Engels, vep. e cit. fq. 86.

të dashtunin mal e fush' me i kaptue, dyshekun me e shtrive, me jargana e me borë me u mbulue, shiu me i zbulue, bryma me i për-vlue, dielli me i lulzue!¹⁰⁰ Njimend vargje këto poetike të rreshtue-me në gradacionin e fuqishëm, por njikohësisht ato nuk japin rrugë-dalje në të realizuemit e synimeve të femnës, — dëshira e saj është e paperspektivë. Kurse, tash në kushtet tona shoqnore femna jonë është pakrahasimisht më e lirë me vendosë vetë mbi fatin e saj bashkëshortor. Njëoftëse ajo has në pengesë nga prindët me u martue me ate që pëlqen, e raste të tilla po ndodhin, atbotë ajo e kap fatin në duert e veta, si shihet nga dialogu i saj me bashkëshortin e ardhshëm:

26



Nan's e babës i kam kallxue,
 Nuk është burr, o j nân çaj për mue!
 Çitu aspak s'du m'u nigue!
 Me djål t'ri du m'u martue!
 — Kçyr, lum dada, shka po bájme-e,
 Me shku n'shpil na nuk guxojm-e,
 Na çortojn-o, çik, ty e mue,
 Pse pa leje jemi martue.
 Ne na duhet çetërkah me shkue,
 Veç me ty, besa, due m'u martue!
 — Oh lum dada, ti kofsh bekue,
 Ti kaç shum çu po m'don mue!
 Pse s'na lán me marr shoçi-shojn-e,
 Ne fabrik drejt na do t'shkojm-e,
 Atje bashk na do t'punojm-e,
 Si e ma mír jetën e sigurojm-e,
 Nan's e bab's s'kem' shka i bájme-e,
 Zemrat tona masi i pengojn-e,
 Na s'muj rrím pa shoçi-shojn-e! 101

Kjo poezi e femnës sonë, me fjalë të thjeshta por e përshkue-me me afsh rinor, sot ka karakter funksional dhe është armë e saj drejt emancipimit sa më të shpejtë. Kjo lirikë e saj është dokument i luftës psikologjike pa kompromis kundër botëkuptimeve dhe paragjytimeve të lidhuna me doke dhe zakone që koha kërkon të hidhen poshtë, pse nuk mund të tolerohen pse janë pengesë për punë pro-

100 Teksti i kangës *Shtat bulbyla krahjeshila* që shënuem nga Rexhep e Tahir Zajazi, më kallnor 1959, mund të shihet n'artikullin tonë Rexhep Zajazi — mjeshtër i kangës popullore, rev. *Përparimi*, Prishtinë, 10/1960, fq. 704—705.

101 Kangën e shënuem nga dy vajza të kat. *Bajçinë, Podujevë*, më gusht 1961. Nji variantë të saj e shënuem në kat. *Isniq, Deçan*, më 1960.

duktive dhe përparimin e gjithanshëm. Prandej emancipimi i femnës sonë është proces i natyrshëm dhe shkon drejt këtij me hapa të shpejtë, sepse simbas gjykimevet të vërtetueme t'Engelsit, femna mund të çlirohet plotësisht kur ajo ja del në krye me marrë pjesë në prodhim në përpjestime shoqnore të gjana, kurse puna shtëpiake e ngarkon në një masë të vogël.¹⁰² Kjo gjë, madje, paraqet ligjshmeninë të vërtetueme historikisht simbas së cilës industrializimi i një vendi tërheq vevetiu edhe fuqinë punëtore të femnës, e cila tue fitue pamvarsinë ekonomike fiton edhe pozitën e re të pamvarun në shoqni, të cilën socializmi shkencor e vlerëson si jashtzakonisht pozitive në zhvillimin e mbarë shoqnisë.¹⁰³

Të paraqitunit e *ambientit t'industrializuem* në kangët popullore shqiptare bashkëkohore, në të cilat shtjellohet puna si motiv, do të thotë një hap para drejt pasunimit motivologjik të poezisë dhe muzikës sonë popullore me tematikë të re. Kjo dëshmon mbi ligjshmeninë e zhvillimit dialektik të krijimtarisë popullore si fenomen shoqnor objektiv, pse provon vërtetësinë që përveç letrarëve dhe artistëve të tjerë të formuem, edhe kangëtarët popullore anonimë, pra njerëzit nga gjiu i masave të gjana popullore, ndiejnë nevojën me i këndue jetës së re — me këndue punën e vet në kushte shoqnore të reja në marrëdhënie socialiste. Kjo, gjithashtu, na provon në mënyrë të pamohueshme një dukuni të përgjithëshme, të cilën qysh moti e theksonte vendosmenisht Maksim Gorki: "... duhet të pranojmë që aftësia e masave punuese në të krijuemit pitoresk me anën e fjalëve po ringjallet dhe patjetër ringjallet pse revolucioni e çliron njeriun jo vetëm fizikisht por edhe emocionalisht, intelektualisht."¹⁰⁴

Një ringjallje e tillë e fuqisë krijuese poetike në gjiun e poezisë popullore shqiptare, në raporte me ndërrimet revolucionare-ndër ne, është fare e dukshme. Këte krijimtari artistike të kangëtarëve tonë popullore e përkrahin vetvetiu modelet muzikore tradicionale, që u ndihmojnë t'i shprehin sa më mirë frymëzimet e tyre në kangët me tematikë nga ndërtimi socialist.

Shembujt muzikorë që shoqnuen disa nga tekstet e kangëve të kumtuem, shumica e tyre me karakter specifik,¹⁰⁵ paraqesin tipare të ndryshme të dialektologjisë së muzikës popullore shqiptare nga trevat folklorike përkatëse.

102 Krah. F. Engels, vep e cit. fq. 189.

103 Përveç veprave të tjera të klasikëve të marksizëm-leninizmit, kemi parasysh në rend të parë, studimet jashtzakonisht të randësishme rreth raporteve midis femnës e punës: August Bebel, *Die Frau und der Socialismus*; Georges Friedmann, *Où va le travail humain?*; Dr. Saša Đuranović-Janda, *Žena u radnom odnosu*; Danica Perić, *Žena u novoj Jugoslaviji*.

104 M. Gorki, vep. e cit. fq. 120.

105 Në trajtesën tonë i kemi vënë në pah vetëm ato elemente muzikore të tyre që kanë randësi thelbore në lidhje me temën tonë, kurse t'analizuemit e tyre të gjithanshëm krahas me materialet muzikore të tjera i takon punimeve të veçanta në kuadrin e etnomuzikologjisë sonë, e cila porsa ka nisë me kriiue pamjen e dialekteve të folklorit muzikor shqiptar.